



ЕЛИМИНАЦИЈА НА МАЧЕЊЕТО  
И НЕЧОВЕЧКОТО ПОСТАПУВАЊЕ  
ВО ЗАТВОРИТЕ И УСТАНОВИТЕ  
ЗА ЛИШУВАЊЕ ОД СЛОБОДА

**RAPORTI I PARË PËR  
GJENDJEN DHE KUSHTET  
NË INSTITUCIONET  
NDËSHKIMORE-KORREKTUESE  
DHE EDUKATIVO-KORREKTUESE  
NË REPUBLIKËN E  
MAQEDONISË SË VERIUT  
I GUSH. - I TET. 2020**

**SHKUP, 2021**

RAPORTI I PARË PËR GJENDJEN DHE KUSHTET NË  
INSTITUCIONET NDËSHKIMORE-KORREKTUESE DHE  
EDUKATIVO-KORREKTUESE NË REPUBLIKËN E  
MAQEDONISË SË VERIUT PËR PERIUDHËN  
1 GUSHT - 1 TETOR 2020



Shkup, 2021

**Botues:** Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, përfaqësuar nga Prof. Dr. Neda Zdraveva

**Redaktore:** Prof. Dr. Aleksandra Gruevska-Drakulevski

**Titulli i botimit:** RAPORTI I PARË PËR GJENDJEN DHE KUSHTET NË INSTITUCIONET NDËSHKIMORE-KORREKTUESE DHE EDUKATIVO-KORREKTUESE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT PËR PERIUHDHËN 1 GUSHT - 1 TETOR 2020

**Autorë:** Ina Xhugumanova, Irena Zdravkova, Arben Gudaçi, Sibel Amet

**Përkthimi:** Shenasi Jaji

**Lektorimi:** Elizabeta Poljoska

**Dizajni grafik dhe shtypja:** Masiva Dooel Shkup

**Vendi i botimit:** Shkup | **Viti i botimit:** 2021 | **Tirazhi i botimit:** 100 ekzemplarë

---

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје  
342.72/.73.037:343.81(497.7)"2020"(047.31)

RAPORTI i parë për gjendjen dhe kushtet në institucionet ndëshkimore-korrektuese dhe edukativo-korrektuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut për periudhën 1 gusht - 1 tetor 2020 / [autorë Ina Xhugumanova ... и др.]. - Shkup : Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut, 2021. - 45 стр.; 21 см

Фусноти кон текстот. - Други автори: Irena Zdravkova, Arben Gudaçi, Sibel Amet. - Содржи и: Aneks 1

ISBN 978-608-4790-82-2

1. Xhugumanova, Ina [автор] 2. Zdravkova, Irena [автор] 3. Gudaçi, Arben [автор] 4. Amet, Sibel [автор]

а) Казнено-поправни установи -- Човекови права -- Заштита -- Македонија -- 2020 -- Истражувања б) Воспитно-поправни установи -- Човекови права -- Заштита -- Македонија -- 2020 -- Истражувања

COBISS.MK-ID 53040389



Ky projekt është mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian



Македонско здружение на млади правници



---

Ky botim është përgatitur me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përbajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e ShMJR-së dhe në asnjë mënyrë nuk i pasqyron qëndrimet e Bashkimit Evropian.

# PËRMBAJTJA

HYRJE .....	1
KORNIZA METODOLOGJIKE .....	4
KONSTATIME TË PËRGJITHSHME NGA VIZITAT NË INSTITUCIONET NDËSHKIMORE-KORREKTUESE DHE EDUKATIVO-KORREKTUESE .....	6
SHTËPIA NDËSHKIMORE-KORREKTUESE IDRIZOVË ME PAVIJON TË HAPUR NË VELES / SHTËPIA EDUKATIVO-KORREKTUESE PËR GRA NË SHTËPINË NDËSHKIMORE-KORREKTUESE IDRIZOVË .....	6
SHTËPIA NDËSHKIMORE-KORREKTUESE SHTIP.....	10
SHTËPIA NDËSHKIMORE-KORREKTUESE PRILEP.....	15
SHTËPIA NDËSHKIMORE-KORREKTUESE E LLOJIT TË HAPUR STRUGË .....	17
BURGU MANASTIR .....	19
BURGU GJEVGJELI .....	22
BURGU KUMANOVË ME PAVIJON TË HAPUR NË KRIVA PALLANKË .....	24
PAVIJONI I HAPUR NË KRIVA PALLANKË NË KUADËR TË BURGUT KUMANOVË .....	27
BURGU OHËR / SHTËPIA EDUKATIVO-KORREKTUESE TETOVË ....	29
BURGU SHKUP .....	34
BURGU STRUMICË .....	37
BURGU TETOVË .....	39
REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME .....	42
ANEKS 1 – Pasqyrë tabelare e vizitave monitoruese .....	44

# HYRJE

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit „Eliminimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor në burgjet dhe institucionet e paraburgimit“, i mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian“. Për qëllimet e projektit është firmosur Memorandum bashkëpunimi midis Shoqatës Maqedonase të Juristëve të Rinj, Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve.

Republika e Maqedonisë së Veriut është ende duke luftuar për të krijuar mekanizma efektivë të brendshëm dhe të jashtëm për parandalimin dhe ndjekjen penale të autorëve në të gjitha rastet e torturës dhe trajtimit çnjerëzor në burgjet dhe institucionet e paraburgimit (privimit nga liria). Faktikisht, qëllimi i këtij projekti është që t'i adresojë problemet sistemore në lidhje me ofrimin e mbrojtjes së personave të privuar nga liria nga çfarëdo lloj torture, trajtimi dhe ndëshkimi çnjerëzor, t'i identifikojë sfidat kryesore për krijimin e mekanizmit efikas për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria dhe t'u jep përparësi masave të nevojshme për krijimin e një mekanizmi të tillë.

Ky raport bazohet në vizitat në terren, të kryera nga ana e përfaqësuesve të Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe përfaqësuesve të Shoqatës Maqedonase të Juristëve të Rinj. Nevoja për të kryer vizita në terren che për ta konstatuar gjendjen faktike në institucionet ndëshkimore-korrektuese lindi nga fakti se këto institucione kanë qenë prej kohësh të mbyllur për publikun e gjerë për shkak të pandemisë së KOVID-19 dhe njëherit ishin subjekt i kritikës së vazhdueshme nga organizatat vendase dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Situata nëpër burgje mund të përkeqësohet nëse në këto institucione nuk merren në kohë masa për parandalimin e përhapjes së virusit KOVID-19. Sa u përket masave të ndërmarra për mbrojtje nga KOVID-19 nga ana e Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve, jemi njoftuar se është miratuar një urdhëresë e cila është shpërndarë në të gjithë institucionet ndëshkimore-korrektuese dhe edukativo-korrektuese, me të cilin urdhër ndalohen përkohësisht privilegjet e personave të dënuar, që do të thotë kontakte më të shpeshta me familjen – vizita në dhe jashtë institucioneve, vizita në shtëpi, pushim vjetor dhe angazhim me punë jashtë institucioneve. Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve ka dorëzuar rekomandime për të gjitha institucionet e vajtjes së dënimit në mënyrë që të trajtojnë virusin KOVID-19. Për zbatimin e masave në secilin institucion ndëshkimore-korrektues dhe edukativo-korrektues zbatohen këto aktivitete: dezinfektimi i përditshëm i hapësirave ku akomodohen personat e dënuar, dhënia e paketave higjienike për higjienë personale për çdo të dënuar, vendosja e preparateve dezinfektuese në hyrjen e çdo institucioni për dezinfektimin e duarve dhe këpucëve, janë furnizuar termometra pa kontakt

me të cilët rregullisht kontrollohet temperatura trupore e të dënuarve, akomodimi në hapësirë të izoluar të çdo të dënuari ose të paraburgosuri të ri për periudhë prej 14 ditësh. Është bërë me dije se deri më 5 maj 2020 në institucionet ndëshkimore-korrektuese në Maqedoni nuk ka asnjë të infektuar me virusin KOVID-19, dhe pas rastit të vdekjes në Burgun e Shkupit i cili pas vdekjes u konstatua si pozitiv, të gjitha testet e tjera të kryera në institucion ishin negative. Deri në momentin e publikimit të këtij raporti, raste pozitive të virusit KOVID-19 ishin regjistruar vetëm në ShNK Idrizovë dhe ShNK Shtip.

Gjë pozitive është që gjatë vizitave nga ekipi u konstatua se pothuajse në të gjitha institucionet ndëshkimore-korrektuese po merren masa për mbrojtje nga përhapja e virusit KOVID-19, veçanërisht sa i përket dezinfektimit të hapësirave. Më tej, pothuajse në të gjitha institucionet e vizituara u janë shpërndarë paketa higjienike të dënuarve, dhe janë kryer kontrole të rregullta të temperaturës së trupit të të dënuarve dhe zyrtarëve që punojnë në këto institucione. Më vonë, me rastin e zbutjes së masave në vend, pothuajse në të gjitha institucionet e vizituara lejoheshin vizitat e të dënuarve nga persona të jashtëm, dhe në përgjithësi lejohej edhe përdorimi i beneficioneve të rregullta që i plotësojnë kushtet.

Megjithatë, shqetëson fakti i efikasitetit në zbatimin e masave të mbrojtjes në institucionet ndëshkimore-korrektuese që ende përballen nga mbipopullimi, kurse në lidhje me sigurimin e dhomave të izolimit për personat të cilët në asnjë rast nuk duhet të barazohen me mjediset për vuajtjen e masës disiplinore – izolim në vetmi, si dhe në institucionet ku kushtet higjienike janë në nivelin më të ulët për shkak të problemeve të furnizimit të rregullt me ujë.

Po i veçojmë disa nga rekomandimet që janë veçanërisht të rëndësishme për sistemin e burgjeve dhe për të cilat ne konsiderojmë se nuk u është kushtuar vëmendje e mjaftueshme nga institucionet e vizituara:

- Brenda çdo institucioni ndëshkimor-korrektues dhe edukativ-korrektues të sigurohen hapësira për vetëizolimn e personave që do të shfaqin simptoma të KOVID-19.
- Shqiptimi i masës - drejtim në vetëizolim, nuk duhet të ngjajë dhe të barazohet me dënimin disiplinor - izolim në vetmi dhe është e nevojshme t'u mundësohet personave të privuar nga liria t'i raportojnë simptomat në kohë, duke e arritur kështu produktivitetin e masës, respektivisht parandalimin e përhapjes së virusit të të gjithë personat e privuar nga liria.
- Dhoma e vetëizolimit në të gjitha institucionet duhet t'i plotësojë standardet e KKT-së për sa i përket madhësisë së arsyeshme të dhomës, dritës natyrore, ajrosjes, dyshekut të pastër, batanijeve, etj.

- Të drejtat themelore të të dënuarve siç janë e drejta për një mjek, e drejta për ajër të pastër dhe e drejta për një avokat nuk duhet të kufizohen dhe institucionet kompetente duhet të bëjnë përpjekje për t'i mundësuar këto të drejta. Sa u përket takimeve me familjen e personave dhe botën e jashtme, kufizimet duhet të kompensohen me lehtë që personat të mund ta përdorin telefonin ose të komunikojnë me internet.

Sistemi penitenciar ende përballlet me probleme dhe sfida të mëdha, veçanërisht sa u përket kushteve materiale, kujdesit shëndetësor, arsimit dhe risocializimit të personave të dënuar. Në këtë drejtim, raporti përmban edhe një përmbledhje të monitorimit të kryer në terren, duke u fokusuar në arritjet dhe sfidat kryesore të dokumentuara gjatë vizitave si dhe në sfidat në lidhje me kujdesin shëndetësor dhe të drejtat e të dënuarve të cilat duhet t'i gëzojnë edhe gjatë kohës së pandemisë me virusin KOVID-19. Raporti gjithashtu përmban edhe rekomandime për secilin institucion ndëshkimor-korrektues dhe edukativo-korrektues, si dhe rekomandime të përgjithshme për institucionet kompetente me qëllim të përmirësimit të situatës dhe kushteve në institucionet ndëshkimore-korrektuese dhe edukativo-korrektuese.

# KORNIZA METODOLOGJIKE

Qëllimi i raportit është të ofrojë një përshkrim të hollësishëm të gjendjes dhe kushteve në institucionet ndëshkimore-korrektuese dhe edukativo-korrektuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Raporti bazohet në vizitat në terren në të gjithë 11 institucionet ndëshkimore-korrektuese dhe institucionet edukativo-korrektuese në vend, që synojnë ta dokumentojnë situatën në institucionet e vizituara, kushtet materiale në të cilat të dënuarit vuajnë dënim me burg, higjienën në institucionet, aktivitetet e lira që i kanë të dënuarit, kontaktet me botën e jashtme, qasja në kujdesin shëndetësor, procesi i risocializimit, si dhe mekanizmi i brendshëm për mbrojtjen, raportimin dhe ndjekjen e të gjitha rasteve të torturës dhe trajtimit çnjerëzor në këto institucione. Gjatë vizitave, është kushtuar vëmendje e veçantë për masat e marra nga autoritetet kundër përhapjes së virusit KOVID-19 në institucionet ndëshkimore-korrektuese dhe edukativo-korrektuese.

Për më tepër, bëhet fjalë për vizita paraprakisht të lajmëruara, në përputhje me planin e miratuar për vizita nga ana e Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve. Vizitat janë kryer gjatë muajve gusht dhe shtator të vitit 2020.

Përfaqësuesit e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe Shoqatës Maqedonase të Juristëve të Rinj të Maqedonisë gjatë vizitave udhëhiqen nga standardet dhe treguesit ndërkombëtarë të vendosur për të drejtat e njeriut të personave të privuar nga liria, siç janë: rregullat standarde minimale për trajtimin e të burgosurve të Kombeve të Bashkuara (rregullat Nelson Mandela)<sup>1</sup>, rregullat evropiane të burgjeve,<sup>2</sup> standardet e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT)<sup>3</sup>, dhe të ngjashme, por duke e marrë në konsideratë edhe Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve<sup>4</sup> dhe aktet e tjera të vlefshme nënligjore të kësaj fushe.

Vizitat në terren në institucionet ndëshkimore-korrektuese dhe edukativo-korrektuese zbatohen bazuar në një metodologji paraprakisht të përcaktuar e cila fokusohet në: trajtimin e personave të privuar nga liria (trajtim çnjerëzor, përdorim të forcës dhe mjeteve të detyrimit), kushtet materiale dhe ushtrimin e të drejtave të personave të dënuar (ushqim, ndriçim, ngrohje, ajrosje, tualete, higjienë personale, rroba, çarçafe, akomodim), aktivitetet e lira, kujdesi shëndetësor dhe të ngjashme.

Ekipi monitorues përbëhet nga juristë, kurse në disa prej vizitave në ekip janë

<sup>1</sup> United Nations Standard Minimum Rules for the Treatment of Prisoners (the Nelson Mandela Rules), A/RES/70/175. Në dispozicion në: <https://undocs.org/A/RES/70/175>. Vizituar më: 9.10.2020.

<sup>2</sup> Recommendation Rec (2006)2 of the Committee of Ministers to member states on the European Prison Rules. Në dispozicion në: [https://search.coe.int/cm/Pages/result\\_details.aspx?ObjectID=090000168005d8d25](https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=090000168005d8d25). Vizituar më: 9.10.2020.

<sup>3</sup> <https://www.coe.int/en/web/cpt/standards#prisons>. Vizituar më: 9.10.2020.

<sup>4</sup> Ligji për Zbatimin e Sanksioneve (Gazeta Zyrtare e RMV Nr.99/2019 dhe 220/2019)



përfshirë edhe avokatë të cilët përveç ofrimit të ndihmës së drejtpërdrejtë juridike për të dënuarit, kanë ofruar edhe dakordim nga personat e dënuar për përfaqësimin e tyre para gjykatave kompetente me qëllim të ushtrimit dhe mbrojtjes së të drejtave të tyre. Për më tepër, përfaqësimi dhe ofrimi i ndihmës juridike nuk ka të bëjë me veprën penale për të cilën janë gjykuar personat.

Pas zbatimit të vizitave, përgatiten raporte të brendshme të cilët dorëzohen në Drejtorinë për Ekzekutimin e Sanksioneve e cila ka mundësi që t'i dorëzojë komentet dhe vërejtjet e saj mbi konstatimet dhe rekomandimet për secilën vizitë në veçanti. Në të paktën 3 institucione ku është vërejtur numër i madh mangësish dhe lëshimesh janë planifikuar vizita të njëpasnjëshme nga ana e ekipit monitorues.

# KONSTATIME TË PËRGJITHSHME NGA VIZITAT NË INSTITUCIONET NDËSHKIMORE-KORREKTUESE DHE EDUKATIVO-KORREKTUESE

## SHTËPIA NDËSHKIMORE-KORREKTUESE IDRIZOVË ME PAVIJON TË HAPUR NË VELES/SHTËPIA EDUKATIVO-KORREKTUESE PËR GRA NË SHTËPINË NDËSHKIMORE-KORREKTUESE IDRIZOVË

### Të dhëna të përgjithshme

ShNK Idrizovë është institucion i llojit të mbyllur ku ekzekutohet dënimi me burg në kohëzgjatje më të gjatë se 3 vite, si dhe dënimi me burg më gjatë se një vit për të burgosurit përsëritës së veprave dhe që më parë kanë qenë të dënuar me burg. Vetëm në ShNK Idrizovë ekziston pavijon i veçantë për gra ku dënimin me burg e vuajnë gra nga i gjithë territori i Republikës së Maqedonisë së Veriut, që janë të dënuara me aktgjykim të plotëfuqishëm me burg. Gjithashtu, në ShNK Idrizovë ekzekutohet edhe dënimi me burg të përjetshëm shqiptuar për burra dhe gra. Në kuadër të institucionit ka edhe pavijon të veçantë për vuajtjen e dënimit me burg shqiptuar burrave dhe grave – shtetas/e të huaj/a dhe personat pa nënshtetësi. Në kuadër të ShNK Idrizovë ka edhe një njësi të veçantë për gratë e dënuara.

Më 10 gusht 2020 ishte realizuar vizita në ShNK Idrizovë. ShNK Idrizovë ka kapacitet për 1.253 shtretër, kurse në çastin e vizitës prezentë ishin 1.082 persona të dënuar. Nga i gjithë numri i përgjithshëm i personave të dënuar në çastin e vizitës, 42 prej tyre ishin gra të burgosura.

Një vizitë shtesë për ndihmë juridike me persona të dënuar është realizuar më 21 gusht 2020.

### Kushtet materiale dhe ushtrimi i të drejtave të personave të dënuar

Sa u përket kapaciteteve ambientale, kushteve materiale dhe higjienës është vërejtur lagështi, myk dhe erë e pakëndshme në pjesët e vjetra të institucionit, më saktë „Ndërtesa“ dhe „Ambulanca“. Në „Ndërtesë“ ishte vërejtur mbipopullim në ambientet e akomodimit, më konkretisht në bllokun 9 dhe bllokun 5 ku takuam nga 22 deri 24 të burgosur në një hapësirë akomodimi. Në disa prej ambienteve janë vërejtur edhe krevatë 3-katësh. Tualetet e përbashkëta prej të cilëve përhapej erë e keqe ishin të papastra, kurse dushet ishin të improvizuara me kova të bëra nga vetë të burgosurit.

Gjatë kohës së vizitës ishin vizituar objektet e reja në ShNK Idrizovë që janë paraparë të akomodojnë 546 persona të dënuar. Ndërtesat e reja janë parashikuar si objekte për pavijone të hapura dhe gjysmë të hapura me qeli katër krevatëshe dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare. Në çastin e vizitës ishin të akomoduar rreth 200 persona të dënuar në këto objekte të reja.

Në lidhje me aktivitetet e lira, personat e dënuar kalojnë dy orë jashtë qelive, kurse vizitat janë të lejuara dy herë në muaj. ShNK Idrizovë ka një oborr të rrethuar ku personat e dënuar e kalojnë kohën e tyre të lirë, por nuk ka kushte për aktivitete të tjera të lira në pjesët e vjetra të burgut, përveç për shëtitje. Aktivitetet e tjera rekreative/të lira përfshijnë gara futbollit dhe basketbollit, bibliotekë, fitnes, ping-pong, shah dhe të tjera.

Sipas të dhënave të marra nga ana e drejtorit të institucionit, rreth 50% e tërë popullatës është e angazhuar me punë brenda ambienteve të institucionit. Për fat të keq, pjesa më e madhe e punëtorëve që kanë funksionuar në të kaluarën janë jofunksionale për një periudhë të gjatë, duke mos iu dhënë mundësi personave të dënuar që të aftësohen, një dobi që do të ishte në favor të tyre pas liritimit nga institucioni.

## **Kujdesi shëndetësor**

Sa i përket kujdesit shëndetësor, ShNK Idrizovë ka në dispozicion dy mjekë të përgjithshëm, një psikiatër (i cili vjen në ditë të caktuara), tri motra medicinale dhe një dentist. Personeli mjekësor punon vetëm ditëve të punës, në një turn, nga ora 07:30 deri në orën 15:30 dhe është përgjegjës për ofrimin e mbrojtjes parësore shëndetësore për të gjithë personat e dënuar në ShNK Idrizovë. Në çastin e vizitës u informuam se ka një të infektuar me COVID-19.

## **Ankesat nga të burgosurit dhe ofrimi i ndihmës juridike**

Gjatë vizitave, pesë personave të dënuar u është ofruar ndihmë e drejtpërdrejtë juridike në lidhje me një çështje të caktuar juridike dhe u njoftuan për mekanizmat e mbrojtjes nga tortura dhe trajtimit çnjerëzor.

Personat e tjerë të dënuar me të cilët u kryen biseda, në përgjithësi ankoreshin për kushtet në institucion dhe kërkuan këshillë juridike në lidhje me përdorimin e beneficioneve gjatë kohës së vuajtjes së dënimit. Më 21 gusht 2020 është zbatuar një vizitë shtesë, me çrast është biseduar vetëm me dy të dënuar me të cilët ekipi kishte biseduar më parë, gjatë vizitës paraprake. Nga ana e institucionit u informuam se asnjë person tjetër i dënuar nuk ka kërkuar ndihmë juridike, kështu që ShNK Idrizovë megjithëse është institucion me numër më të madh të personave të dënuar që e vuajnë dënimin me burg, deri më tani është biseduar me një numër të vogël të të dënuarve nga ana e juristëve dhe avokatëve tanë.

Gjatë kohës së vizitës, ekipi u njoftua se personat e dënuar kanë mundësi për vizita në institucion. Në përgjithësi, personat e dënuar që i përmbushin kushtet mund t'i përdorin beneficinet, respektivisht dalje nga institucioni.

## **Pavijoni i grave**

Pavijoni i veçantë në ShNK Idrizovë për gratë që e vuajnë dënimin me burg (në tekstin e mëtejshëm: Pavijoni i grave) funksionon si objekt veçmas i ndarë në ShNK Idrizovë. Në kuadër të pavijonit të grave funksionon edhe shtëpia edukativo-korrektuese për gra. Gjatë kohës së vizitës asnjë vajzë nuk vuante masë dënimi në shtëpinë edukativo-korrektuese.

Pavijoni i grave ka tre regjime të ndryshme sigurie të ndarë në dy blloqe. Sa u përket kapaciteteve ambientale, kushteve materiale dhe higjienës, pavijoni i hapur dhe gjysmë i hapur ka një korridor dhe katër dhoma për akomodimin e grave të burgosura. Kapaciteti i pavijonit është 15 shtretër, kurse në çastin e vizitës ndodheshin tetë gra të burgosura. Të gjitha dhomat kishin dritare të mëdha për ndriçim natyror dhe ishin të pajisura me televizorë të cilët i kishin sjellë vetë të burgosurat. Shumica e çarçafëve në krevatet është sjellë nga ana e familjarëve të të dënuarave, megjithëse edhe burgu ka mundësi të sigurojë çarçafë për secilën grua të burgosur. Sipas informacioneve nga të punësuarit, të gjitha dhomat janë të lidhura me ngrohjen qendrore të burgut, edhe pse në shumicën e dhomave u vërejtën pajisje për ngrohje që ishin sjellë nga të burgosurat.

Pavijoni i mbyllur ka 14 dhoma për akomodimin e të burgosurave dhe korridor me raftë të shënuara me emra për sendet personale të grave të burgosura. Kapaciteti i pavijonit të mbyllur është 55 shtretër, kurse në kohën e vizitës aty ishin të akomoduar 34 të burgosura. Pavijoni i mbyllur ka dy hapësira për dënimin - izolim në vetmi, depo për materiale të vjetra, dy dhoma boshe me soba që shërbejnë si kuzhina ditore, dy tualete dhe një tualet i pajisur me kabina dushi dhe një dhe makinë për larjen e rrobave. Dhomat në pavijonin e mbyllur janë të pajisura me maksimalisht pesë krevatë në një dhomë. Të gjitha dhomat kanë ndriçim adekuat ditor, mirëpo çarjet nëpër mure nga lagështia dhe era e pakëndshme ishin prezente në të gjitha dhomat. Në të gjitha dhomat u vërejt ushqim dhe pije, disa prej personave të dënuara posedojnë frigoriferë për ruajtjen e ushqimit, ndërsa të tjerat këto gjëra i ruajnë jashtë, në ambient të hapur. Pavijoni i mbyllur ka katër kabina dushi me dyer të thyera, nga të cilat njëra kabinë është krejtësisht jashtë përdorimit, kurse dritaret janë të thyera dhe nga jashtë depërton ajër i ftohtë.

Sa i përket angazhimit me punë dhe aktiviteteve të lira, gratë e burgosura zakonisht përfshihen në aktivitete dhe aftësim profesional siç janë orët për qepje dhe parukeri si dhe angazhimi i tyre në kuzhinë dhe larjen e rrobave. Kur u pyetën se në cilat aktivitete përfshihen të burgosurat, u theksua se përveç trajnimit për qepje dhe parukeri, ato janë të angazhuara në kuzhinë, në

larje të rrobave, në ndërtesën administrative dhe pjesa tjetër janë të angazhuara me higjienën nëpër korridore dhe tualete. Pavijoni i grave nuk ka kushte, madje as programe për plotësimin e kohës së lirë të burgosura. Oborri në pavijonin e grave nuk ofron hapësirë për stërvitje dhe rekreacion, përveç për shëtitje dhe vrapim. Madje edhe këto aktivitete janë të kufizuara sepse oborri është i vogël dhe nuk ka çati të përshtatshme në rastet kur moti është me shi ose borë.

### **Rekomandime:**

- Të parandalohet mbipopullimi i mundshëm në institucionet, që në një situatë të të dënuarve të infektuar ndoshta mund ta shkaktojë përhapjen e shpejtë të virusit KOVID-19 midis personave të dënuar, e kjo do ta rëndonte të gjithë sistemin shëndetësor.
- Duhet të merren masa urgjente për t'i përmirësuar kushtet materiale në seksionet "Ndërtesa" dhe "Ambulanca", sepse të njëjtat janë çnjerëzore dhe degraduese për të dënuarit.
- Të përmirësohet qasja e të dënuarve te mjeku dhe kujdesi shëndetësor dhe të sigurohen vizita më të shpeshta te mjeku në institucionin në mënyrë që të dënuarit t'i raportojnë me kohë simptomat e virusit KOVID-19.
- Të bëhen përpjekje që punëtoritë të vihen përsëri në funksion, në mënyrë që personat e dënuar të përfitojnë aftësi për punë.

# SHTËPIA NDËSHKIMORE-KORREKTUESE SHTIP

## Të dhëna të përgjithshme

ShNK Shtip është institucion i llojit të mbyllur në të cilin zbatohen dënimet me burg në kohëzgjatje më të gjatë se 3 vite, si dhe dënimet me burg më të gjatë se një vit për përsëritësit e veprave të dënuar me dënim me burg.

Në ditën e vizitës më 18 gusht 2020 dënimin me burg e vuanin 212 persona të dënuar, ndërsa kapaciteti i përgjithshëm i institucionit është për 210 persona të dënuar. Një vizitë shtesë në lidhje me ofrimin e ndihmës juridike personave të dënuar u realizua më 1 shtator 2020.

Në ShNK Shtip janë të punësuar gjithsej 96 persona – policë të burgut, nga të cilët tri janë gra. Gjatë kohës së vizitës u bisedua me një edukator dhe dy juristë. Në Sektorin për risocializim janë të angazhuar gjithsej pesë persona.

## Kushtet materiale dhe ushtrimi i të drejtave të personave të dënuar

Pjesa administrative e ndërtesës gjendet në anën e djathtë të hyrjes së institucionit dhe aty gjendet zyra e drejtorit dhe zyrat e tjera administrative.

Në anën e djathtë gjendet edhe objekti që shfrytëzohet si ambulancë. Objekti është rinovuar dhe higjiena është në një nivel më të lartë, krahasuar me higjienën në kapacitetet e akomodimit.

Ambientet për vuajtjen e dënimit disiplinor – izolim në vetmi gjenden në ndërtesën ku gjendet edhe pavijoni i mbyllur. Sipas komandantit, për vuajtjen e masës disiplinore – izolim në vetmi përdoren tri dhoma. Çdo dhomë është me dy shtretër. Gjatë kohës së vizitës, ekipi takoi tre persona të akomoduar në dy dhoma të ndryshme. Dy persona ishin të akomoduar bashkë në një qeli për dënim me izolim, sipas tyre vullnetarisht, për shkak se në pjesën ku e kanë vuajtur dënimin ka shpërthyer një tub uji dhe në ditën e vizitës ata kishin qenë të akomoduar aty për pesë ditë. Personat e dënuar nuk ishin të informuar se kur do të riparohej dëmi, që të mund të kthehen përsëri në pjesën gjysmë të hapur. Ata nuk kishin ankesa në lidhje me kushtet në atë hapësirë dhe nuk dëshironin të bisedonin me ekipin.

Në dhomën tjetër takuam një person i cili, sipas komandantit, dëshironte vullnetarisht të zhvendoseshte në këtë dhomë, sepse ndjehej i shqetësuar në pjesën ku ishte akomoduar. I njëjti person deklaroi se për shkak të kushteve në dhomë, e cila në të vërtetë është qeli për izolim në vetmi, ai nuk dëshiron të qëndrojë më në të dhe për disa ditë i drejtohet komandantit, por përgjigjja e komandantit ishte se ai ka dashur vullnetarisht të pushojë mendërisht, prandaj është akomoduar aty. Pas reagimit të ekipit, komandanti tha se ka hapësirë dhe së shpejti do të transferohej në pjesën ku ka qëndruar më parë.

Akomodimi i personave në këto dhoma është në kushte jashtëzakonisht poshtëruese dhe degraduese dhe në asnjë rast nuk duhet të akomodohen dy persona në një dhomë të tillë, në të cilën nuk ka privatësi madje as për kryerjen e nevojave themelore fiziologjike. Kapacitetet e akomodimit në këto ambiente, së bashku me kapacitetet e tjera të akomodimit nuk i plotësojnë as standardet minimale sa i përket madhësisë së hapësirës për një person të dënuar, kurse disa prej ambienteve nuk i plotësojnë kushtet sa i përket lagështisë, ndriçimit dhe ajrosjes.

Ky lloj i akomodimit të personave në qeli për izolim në vetmi të destinuar për vuajtjen e dënimit disiplinor-izolim në vetmi është kryesisht i papërshtatshëm për shkak të pasigurisë së kohëzgjatjes së qëndrimit të personave.

Kapacitetet e akomodimit në pavijonin gjysmë të hapur nuk i plotësojnë standardet minimale sa i përket madhësisë së hapësirës. Në disa prej hapësirave janë akomoduar shtatë persona, që është më shumë se kapaciteti i hapësirës.

Pothuajse të gjitha hapësirat janë të pajisura me televizorë, dollape, tavolina dhe karrige.

Në katin e parë të pavijonit gjysmë të hapur është rinovuar një hapësirë dhe e njëjta shërben si bibliotekë. Në bibliotekën ka zgjedhje librash, tavolina dhe karrige.

Pavijoni i mbyllur gjendet në ndërtesë të veçantë, e ndarë nga hapësira tjetër me oborr të veçantë për shëtitje të personave të dënuar. Në secilin kat ka nga tri hapësira për qëndrim ditor. Këto hapësira në të tre krahët janë të pajisura ndryshe. Në krahun e parë, i cili ndodhet në katin e parë, një dhomë për qëndrim ditor përdoret si palestër dhe ka pajisje për ushtrime. Dhoma e dytë përdoret si kuzhinë dhe ka dy frigoriferë, sobë, tavolinë, karrige dhe gjithçka tjetër që është e nevojshme për funksionimin e zakonshëm. Dhoma e tretë përdoret si sallë me televizor dhe është e pajisur me një televizor më bashkëkohor, tavolinë, karrige etj. Në këtë kat ka tualet dhe banjo, ku higjiena është në nivel të kënaqshëm. Në të tre katet ka frigoriferë të rinj. Për dallim nga krahu i parë, në krahun e dytë, ku janë akomoduar kryesisht persona të dënuar të përkatësisë etnike rome, kushtet janë shumë më të këqija. Vërehen shumë mbeturina nëpër korridore dhe një erë e pakëndshme. Sipas policisë së burgjeve kjo është rezultat i mungesës së mirëmbajtjes nga ana e vetë personave të dënuar. Hapësirat e akomodimit janë në gjendje të keqe dhe në kuzhinë ka vetëm një sobë për gatim. Tualeti është në një gjendje shumë të keqe, por sipas komandantit, është planifikuar të fillojë rinovimi i tij. Në të gjitha krahët, buka ishte vendosur në rafta pa u paketuar siç duhet dhe pa mbajtur kujdes për standardet e ruajtjes së ushqimit. Nuk ka asnjë pajisje ushtrimi në palestër, nuk ka karrige, as tavolinë, madje as televizor në dhomën e ndenjes. Dhoma e tretë është e mbyllur dhe nuk përdoret fare. Në krahun e tretë, i cili ndodhet në katin e tretë, kushtet në të tre dhomat janë

shumë më të mira sesa kushtet në krahun e dytë, por gjithashtu shumë më të këqia sesa kushtet në krahun e parë. Vërehet dallim në të tre krahët nga njëri-tjetri.

## **Kujdesi shëndetësor**

Institucioni ka angazhuar një mjek që punon me orar të plotë në burgun. Ekipi bisedoi me mjekun i cili na bëri me dije se nuk ka ilaçe të mjaftueshme dhe nganjëherë të dënuarit paguajnë vetë. Ai gjithashtu na informoi për dy të dënuar për të cilët e ka dhënë rekomandimin e tij se ata duhej pezulluar nga vuajtja e dënimit për shkak të intervenimeve të duhura mjekësore, por të njëjtët janë refuzuar. Personi që parashtroi një ankesë në Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, deklaroi se ka probleme me frymëmarrjen dhe se ka nevojë për intervenim kirurgjik, për të cilin ka dhe rekomandim nga mjeku i burgut. Pas insistimit të personit që të dërgohet te një mjek në spitalin e Shtipit, nga Qendra e Shëndetit Shtip është marrë vetëm një njoftim se nuk është e mundur të bëhet një ndërhyrje e tillë për shkak të pandemisë së virusit KOVID-19. Sipas pretendimit të zëvendës drejtorit, të gjitha ankesat dorëzohen rregullisht, si dhe që ka kuti të veçanta postare që mund të përdoren nga të dënuarit, kurse çelës ka vetëm Avokati i Popullit.

Ekipi gjithashtu bisedoi me infermieren e cila na informoi se tashmë është angazhuar një dentist dhe nuk ka nevojë që të dënuarit të dërgohen në qytetin e Shtipit, përveç nëse nevojitet ndërhyrje më serioze.

## **Ankesat nga të burgosurit dhe ofrimi i ndihmës juridike**

Gjatë vizitës së kryer më 14 shtator 2020, 14 të dënuarve u është ofruar ndihmë e drejtpërdrejtë juridike për një çështje të caktuar juridike dhe janë njoftuar me mekanizmat për mbrojtje nga tortura dhe trajtimi çnjerëzor.

Nga një grup i të dënuarve, më saktësisht nga 11 të dënuar, u informuam se nga muaji prill/maj 2020 janë paraqitur sfida dhe paqartësi në lidhje me zbatimin e Nenit 12 të Rregullores për vendosjen, klasifikimin dhe zhvendosjen e të dënuarve në institucionet ndëshkimore-korrektuese.<sup>5</sup> Gjegjësisht, ky nen e rregullon çështjen e zhvendosjes së të dënuarve në institucione të llojit të mbyllur, i cili parasheh një kusht shtesë për të dënuarit që kanë kryer shkelje të caktuara disiplinore, dhe kjo është që të kenë vuajtur ¾ të pjesës së pashlyer të dënimit. Personat e dënuar të cilët raportuan problem me zbatimin e kësaj dispozite të Rregullores, janë persona që kanë kryer arratisje, përpjekje për arratisje, kthim paskohe nga ndërprerja e dënimit para hyrjes në fuqi të Rregullores, respektivisht në vitin 2016, 2018 dhe 2019, dhe për shkeljen disiplinore u është shqiptuar masë disiplinore. Të gjithë këta të dënuar nuk mund t'i përdorin privilegjet jashtë institucionit. Kjo

<sup>5</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut Nr. 87 më 2 Prill 2020.



dispozitë dhe zbatimi i saj praktik ka si pasojë vlefshmëri retroaktive të Rregullores për kushtet para miratimit të saj, në dëm të personave të dënuar, e që krijon pasiguri juridike.

Si një ankesë më specifike në lidhje me angazhimin në punë, ishte ankesa e një personi i dënuar i cili me materialet dhe mundin e vet përgatit vepra artizanale që pastaj ia marrin policiët e burgut për pak para ose në disa raste edhe pa kompensim. Nëse ai nuk bie dakord për këtë, veprat e tij i dëmtohen dhe kështu e humbin vlerën.

Gjatë kohës së vizitës, në bisedë me të dënuarit, është marrë informacioni se të dënuarit kanë mundësi për vizita si dhe të përdorin privilegje që do të thotë dalje nga institucioni, me përjashtim të personave që i raportuan problemet në lidhje me Rregulloren e re për vendosjen, klasifikimin dhe zhvendosjen e personave të dënuar në institucionet ndëshkimore-korrektuese.

### **Rekomandime:**

- Pajisje dhe mirëmbajtje adekuate të ambienteve në të tre krahët në mënyrë që ato të mund t'i plotësojnë kushtet e nevojshme për vuajtjen e dënimit me burg të personave të dënuar.
- Megjithëse është bërë progres në uljen e numrit të të dënuarve që vuajnë dënim në këtë institucion, rekomandohet që të kihet kujdes të mos tejkalohet kapaciteti i akomodimit në institucion, pasi në rast të pandemisë dhe individë të infektuar rishtas, kjo mund të rezultojë me përhapje më të shpejtë të virusit KOVID-19 midis të dënuarve.
- Duhet të merren masa të menjëhershme për t'i përmirësuar kushtet materiale në krahun 2 në pjesën e mbyllur, veçanërisht në tualetin e përbashkët i cili është në një gjendje shumë të keqe.
- Personat e dënuar nuk duhet të vendosen në mjediset e destinuar për vuajtjen e një mase disiplinore në qeli për izolim në vetmi pa qenë të dënuar me këtë masë disiplinore. Vendosja e dy personave pa qenë të dënuar me masën disiplinore – izolim në qeli në të njëjtën dhomë që dedikohet për vuajtjen e masës disiplinore – izolim në qeli përfaqëson një akt çnjerëzor dhe degradues dhe ndikon në integritetin fizik dhe moral të personit (për shembull, të dënuarit nuk mund t'i kryejnë nevojat e tyre fiziologjike).
- Të miratohet një Rregullore e re për vendosjen, klasifikimin dhe zhvendosjen e të dënuarve në institucionet ndëshkimore-korrektuese në mënyrë që të rregullohen më qartë çështjet që lidhen me të gjitha situatat që kanë lindur para hyrjes së saj në fuqi.

- T'u sigurohet qasje të dënuarve në kujdesin shëndetësor jashtë institucionit në rastet kur nevoja për këtë konstatohet nga mjeku i punësuar në institucion dhe ndërhyrja mjekësore nuk mund të kryhet për shkak të kufizimeve të Shtëpisë së shëndetit publik Shtip, në lidhje me pranimin e pacientëve në kushte të pandemisë me KOVID-19.

# SHTËPIA NDËSHKIMORE-KORREKTUESE PRILEP

## Të dhëna të përgjithshme

Me Ligjin e ri për Ekzekutimin e Sanksioneve nga viti 2019, institucioni ndëshkimor-korrektues në Prilep është institucion ndëshkimor-korrektues i llojit të mbyllur në të cilin ekzekutohet dënimi me burgim prej më shumë se tre vjet, si dhe dënimi me burgim prej më shumë se një vit për të dënuarit-përsëritës të dënuar më parë me burg.

Vizita një-ditore në ShNK Prilep u realizua më 3 shtator 2020. Institucioni ka kapacitet për rreth 110 persona. Në kohën e vizitës, numri i të burgosurve ishte 87 persona, njëri prej të cilëve ishte shtetas i huaj. ShNK Prilep ka 71 të punësuar, nga të cilët 45 janë nëpunës me uniformë dhe katër janë edukatorë. Nuk ka avokat të punësuar, kurse ndihma juridike sigurohet nga punonjësit në sektorin për risocializim.

## Kushtet materiale dhe ushtrimi i të drejtave të personave të dënuar

Në ShNK Prilep ekziston një pavijon pritjeje (dy dhoma), pavijon i hapur (gjashtë dhoma), pavijon gjysmë i hapur (shtatë dhoma) dhe pavijon i mbyllur (katër dhoma), palestër, dhomë për aktivitete të ndryshme, dhomë për pastrim rrobash, kuzhinë, dhomë ngrënie, dhomë për kontroll dhe vizita, ambulancë dhe farmaci, shëtitore dhe fermë.

Në këtë institucion ndëshkimor-korrektues nga ky vit nuk ka më njësi paraburgimi, kurse hapësira është ridestinuuar në pjesë izolimi të llojit të mbyllur, ku në ditën e vizitës për shkaqe sigurie ishte akomoduar vetëm një person. Kapaciteti i pjesës për izolim është për tetë persona, kurse dhomat janë plotësisht të rinovuara. Njëra nga dhomat që e vizituam, në të cilën ndodhej personi që ishte akomoduar aty, kishte një shtrat, një televizor, një tavolinë, një tualet, muret ishin ngjyrosur dhe higjiena ishte në një nivel të kënaqshëm.

Hapësira e shëtitjes për të dënuarit që gjendet në këtë pjesë është një hapësirë e hapur, e rrethuar me mur të lartë betoni. Hapësira ishte e zbrazët pa ndonjë pajisje për aktivitete rekreative. Shëtitorja për të dënuarit e tjerë është e gjerë, me tavolina dhe karrige për ulje dhe dy fusha sportive për futboll dhe basketboll.

Niveli i higjienës në dhomat e pavijonit të hapur dhe gjysmë të hapur në të cilën janë akomoduar të dënuarit është relativisht e kënaqshme, me dritare mjaft të mëdha ku hyn drita e diellit dhe ka mundësi për ajrosje. Dhomat janë të pajisura me shtretër, tavolina, karrige, ngrohje, dhe në disa prej dhomave ka edhe televizorë.

Në këto hapësira nuk është instaluar asnjë sistem thirrjeje/alarmi, për shkak

të së cilës në rast urgjence të dënuarit duhet t'i thërrasin punonjësit duke bërtitur ose trokitur në dyert.

Tualetet e përbashkëta u gjetën në gjendje shumë të keqe, me nivele të larta të lagështisë dhe nivele të ulëta të higjienës. Vëreheshte se në dyshemetë e tualeteve kishte ujë, si dhe pasqyra të thyera.

## **Kujdesi shëndetësor**

Kujdesi shëndetësor në ShNK Prilep sigurohet nga një mjek, neuropsikiatër, i cili vjen në institucionin një herë në javë dhe dy infermiere të cilat janë të punësuar në institucion me orar të plotë pune. Shërbimet dentare për personat e dënuar sigurohen përmes ndihmës së shpejtë mjekësore.

## **Ankesat nga të burgosurit dhe ofrimi i ndihmës juridike**

Gjatë vizitës së nëntë të dënuarve, u ofrua ndihmë e drejtpërdrejtë juridike në lidhje me një çështje të caktuar juridike dhe ata u njoftuan me mekanizmat për mbrojtje nga tortura dhe trajtimi çnjerëzor.

Një shtetas i huaj që vuan dënim me burg në këtë institucion na informoi se shtetasit e huaj në këtë, por edhe në të gjitha burgjet e tjera, nuk mund t'i përdorin privilegjet sikurse personat e tjerë të dënuar që janë shtetas të Maqedonisë së Veriut. Një person i dënuar u ankua se kishte tuberkuloz, me të cilën ishte infektuar gjatë qëndrimit në institucionin dhe për të cilin ai kërkon ndërprerje të dënimit që të mund të kurohet.

Gjatë vizitës, ekipi mori informacion se të dënuarit në institucion kanë edhe të drejtë vizitash. Në përgjithësi, të dënuarit që i plotësojnë kushtet mund të përdorin privilegje, përkatësisht, të mund të dalin nga institucioni.

## **Rekomandime:**

- Zëvendësimi ose rehabilitimi i menjëhershëm i pajisjeve jofunkionale në tualetet e përbashkëta dhe mirëmbajtja e higjienës së tyre.
- Pajisja e shëtitores me pajisje për të dënuarit që janë vendosur në pjesën e izolimit - pavijonin e mbyllur, që të mund ta kalojnë jashtë kohën e tyre të lirë në mënyrë produktive.
- Në hapësirat e personave të dënuar duhet të instalohen sistemet e thirrjes/alarmit për raste të urgjencës.
- Të përmirësohet qasja e të dënuarve te mjeku dhe kujdesi shëndetësor në mënyrë që të dënuarit t'i raportojnë me kohë simptomat e virusit COVID-19.

# SHTËPIA NDËSHKIMORE-KORREKTUESE E LLOJIT TË HAPUR STRUGË

## Të dhëna të përgjithshme

ShNK Strugë është një institucion ndëshkimor-korrektues i llojit të hapur në të cilin ekzekutohet dënimi me burg i personave të dënuar për vepra penale të kryera nga pakujdesia dhe vepra të tjera penale me burg deri në tre vjet, nëse mund të pritet me arsye që procedurat në këto institucione korrespondojnë me karakterin e veprës penale dhe e personit dhe që në këtë lloj institucioni me ndjenjën e përgjegjësisë personale ata do t'i kryejnë detyrat e tyre dhe nuk do ta abuzojnë qendrimin aty.

Më 10 shtator 2020, ekipi i monitorimit realizoi një vizitë një-ditore në ShNK Strugë.

Institucioni ka kapacitet për 60 persona. Në kohën e vizitës në institucion, dënimin me burg po e vuanin gjithsej 19 persona, shtatë prej të cilëve janë të angazhuar me punë jashtë institucionit. Numri i përgjithshëm i personave të punësuar në policinë e burgut është 12, në sektorin e risocializimit janë të punësuar tre persona dhe një avokat. Policia e burgut punon në dy ndërrime nga 12 orë në ditë.

## Kushtet materiale dhe ushtrimi i të drejtave të personave të dënuar

Në ShNK Strugë ka gjithsej 12 dhoma me dy, tre dhe katër shtretër. Dhomat u gjetën në kushte të pranueshme me një nivel të kënaqshëm higjienik. Në institucionin ka edhe tualete të përbashkëta, nga të cilët vetëm dy dushe ishin në funksion, kurse dyert e tualeteve të përbashkëta ishin të thyera.

Drejtori i institucionit vuri në dukje se problemi më i madh me të cilin përballen është mungesa e ngrohjes gjatë dimrit. Ai na informoi se gjatë dimrit, dhomat ngrohen me pajisje të ngrohjes për shkak të së cilës institucioni ndan një shumë të madhe fondesh për t'i paguar faturat e energjisë elektrike. Gjithashtu, si një problem tjetër u raportua edhe shkujti me të cilin përballen gjatë dimrit për shkak të dritareve të thyera në korridorët e institucionit.

## Kujdesi shëndetësor

Kujdesi shëndetësor në ShNK Strugë sigurohet nga Ndihma e shpejtë mjekësore. Sipas nevojës, në institucion vjen një mjek, një herë në javë.

## **Ankesat nga të burgosurit dhe ofrimi i ndihmës juridike**

Gjatë vizitës, një nga të dënuarit kërkoi ndihmë humanitare me rroba, sepse atij nuk ka kush t'ia sigurojë atë, kurse institucioni gjithashtu nuk ka fonde. Nga ana e institucionit u informuam se edhe dy të dënuar të tjerë janë në një situatë të ngjashme dhe se nëse gjejmë një mënyrë, do të ishte mirë t'u ndihmojmë këtyre tre personave. Ata gjithashtu e theksuan nevojën për të siguruar ndihmë post-penale në formën e ndihmës sociale dhe strehim pas vuajtjes së dënimit të tyre.

### **Rekomandime:**

- Të zgjidhet urgjentisht problemi me ngrohjen në institucion.
- Të riparohen urgjentisht dritaret e thyera, prej të cilave depërton shkuji.
- Të riparohet urgjentisht dera e thyer në tualetin e përbashkët të dhomat.
- Të riparohen dushet që janë jashtë përdorimit.

# BURGU MANASTIR

## Të dhëna të përgjithshme

Burgu Manastir është një institucion ndëshkimor-korrektues i llojit gjysmë të hapur në të cilin ekzekutohet dënimi me burgim deri në tre vjet, si dhe dënimi me burgim deri në një vit për përsëritësit e veprave penale të dënuar më parë me burgim. Në këtë burg ka edhe një njësi paraburgimi.

Ekipi monitorues më 4 shtator 2020 realizoi një vizitë një-ditore në Burgun Manastir.

Nga zëvendës-drejtori u informuam se ende pritet miratimi nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve për lëshimin në përdorim të burgut dhe kështu të bëhet transferimi i të dënuarve nga institucioni ku ata janë të vendosur për kohësisht, në objektin e ri të burgut në Manastir.

## Kushtet materiale dhe ushtrimi i të drejtave të personave të dënuar

Këtë vit, përfundoi rindërtimi i Burgut Manastir, i cili u financua nga Bashkimi Evropian. Rindërtimi përfshiu punë ndërtimore dhe një renditje krejtësisht të re të dhomave të gjumit, duke e zvogëluar numrin e të dënuarve që qëndrojnë në një dhomë, si dhe pajisje të plotë të ambienteve ku do të akomodohen personat e dënuar. Çdo dhomë gjumi e ka banjon e vet, tavolinë me karrige, televizor, çarçafë të ri dhe një sërë sendesh për mirëmbajtjen e higjienës personale. Sistemi i ri i ngrohjes dhe ftohjes gjithashtu do t'i përmirësojë kushtet e burgut si për të dënuarit dhe të paraburgosurit, ashtu edhe për personelin, kurse policia e burgut ka marrë një sistem krejtësisht të ri për mbikëqyrjen e personave të dënuar. Përveç dhomave të gjumit, ne i vizituam edhe dhomat e destinuara për bibliotekë, palestër, kuzhinë, dhomë ngrënie, pastrim rrobash, depo për ruajtjen e ushqimit, sallë me televizor dhe ambulancë që ka qasje për karrocë me rrota dhe dy dhoma për rite fetare.

Pjesa e rindërtuar e Burgut, e cila aktualisht nuk strehon të dënuar dhe të paraburgosur, ka kapacitet akomodimi për 83 persona. Burgu ka një njësi pritjeje me kapacitet për shtatë persona, një pavijon të hapur me kapacitet për pesë dhoma për rreth 50 persona, një pavijon të mbyllur me kapacitet për rreth 30 persona dhe një njësi paraburgimi me pesë dhoma me kapacitet për rreth 30 persona.

Përkundër faktit se të gjitha dhomat janë ripajisur me mobilje të reja, sistem të ftohjes dhe ngrohjes, alarm emergjence, kemi vërejtur që tualetet nuk janë bërë në mënyrë adekuate. Gjegjësisht, tualetet nuk janë të ndara dhe, përkundër faktit që prej aty do të përhapet erë e pakëndshme, personi nuk do ta ketë privatësinë e duhur, sepse shtretërit në dhomë janë në dy kate, kështu që nëse dikush është në shtratin në kat, ai do të mund ta shohë personin i cili

është në tualet.

Megjithëse sistemi i ftohjes dhe ngrohjes është instaluar siç duhet, ne kemi vërejtur që dritaret në dhomat hapen minimalisht për shkak të së cilës njerëzit nuk do të mundën ta ajrosin dhomën. Lidhur me vërejtjet, ekipi mori një përgjigje se rinovimi është kryer në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe ata e kanë parasysh mbrojtjen e të drejtave të njeriut të personave të dënuar.

Shëtitorja e burgut ishte një hapësirë e zbrazët, e ndarë me një mur të lartë betoni dhe në vetë shëtitoren ishte vendosur një kosh basketbolli. Nga ana jonë ishte vërejtur dhe është bërë me dije se është e nevojshme të vendosen rekuizita shtesë ma qëllim që të dënuarit ta kalojnë kohën e tyre të lirë në mënyrë më produktive.

Pjesa ku aktualisht janë akomoduar të dënuarit ndodhet disa kilometra larg nga pjesa e rindërtuar e Burgut. Për momentin, aty dënimin me burg e vuajnë 16 persona, kurse kapaciteti është për 24 persona. Hapësira ka gjashtë dhoma dhe është gjetur në kushte të këqija higjienike me orendi të vjetra. Të dënuarit deklaruan se nuk marrin paketa higjienike.

Megjithëse në atë pjesë ka tokë të punueshme dhe një fermë ku të dënuarit mund të angazhohen me punë, në kohën e vizitës nuk gjetëm persona të angazhuar me punë. Në burg janë të punësuar 54 persona, prej të cilëve 25 janë nëpunës të policisë së burgut. Është punësuar një person në ekipin e risocializimit dhe nuk është punësuar asnjë jurist.

## **Kujdesi shëndetësor**

Kujdesi shëndetësor në Burgun Manastir sigurohet përmes thirrjeve të Ndhmës së shpejtë mjekësore. Burgu nuk ka mjek të punësuar dhe nuk ka as ambulancë ku do të mund të kryheshin kontrole shëndetësore.

## **Ankesat nga të burgosurit dhe ofrimi i ndihmës juridike**

Gjatë vizitës, ekipi foli me pesë të dënuar të cilëve u dha ndihmë të drejtpërdrejtë juridike.

Çështjet juridike u referoheshin privilegjeve të personave të dënuar - përdorimi i një fundjave nga ana e personit të dënuar, përdorimi i një të drejte juridike nga ana e personit të dënuar në lidhje me vendimin me të cilin është shqiptuar masa disiplinore, përdorimi i kujdesit shëndetësor.

Personi i dënuar kërkoi këshilla juridike në lidhje me mekanizmat ligjorë për mbrojtjen e të drejtave të tij, përkatësisht shprehu shqetësim në lidhje me përcjelljen e kërkesave të tij në Drejtorinë për Ekzekutimin e Sanksioneve sepse nuk i është dhënë kopje ose ndonjë provë tjetër që kërkesat janë parashtruar.



Në Burgun Manastir po e vuan dënimin një person i dënuar që është në një gjendje dukshëm të përkeqësuar të shëndetit mendor. Për këtë person kujdesen të dënuarit dhe policia e burgut të cilët ia ndërrojnë rrobat dhe i japin terapi mjekësore të përshkruar nga një psikiatër. Nga ana e policisë së burgjeve u informuam se gjendja shëndetësore e personit nuk monitorohet rregullisht nga një mjek profesionist për shkak të së cilës ekziston shqetësimi se dhe terapia që ai aktualisht e merr, nuk është adekuate për gjendjen e tij shëndetësore.

### **Rekomandime:**

- Të ndahen tualetet në pjesën e rinovuar të burgut në mënyrë që të parandalohet përhapja e erës së pakëndshme në dhomë dhe që të mbrohet privatësia e të dënuarve.
- Të transferohen menjëherë të dënuarit nga institucioni i përkohshëm i burgut dhe të rregullohet në kohë hapësira e ambientit të ri për shëtitje dhe relaksim të të dënuarve.
- Të përmirësohet aksesimi i të dënuarve te një mjek dhe në kujdesin shëndetësor dhe të sigurohen vizita më të shpeshta të mjekut në institucion, veçanërisht për faktin se institucioni strehon një person me një gjendje dukshëm të përkeqësuar mendore, për të cilin kujdesen të dënuarit e tjerë.
- Megjithëse deri më tani nuk ka persona të dënuar në burg të infektuar me virusin KOVID-19, në marrëveshje me ISHP Gjevgjeli të duhet të sigurohen vizita më të shpeshta nga ana e një mjeku në institucionin (3 herë në javë) në mënyrë që të dënuarit t'i raportojnë në kohë simptomat e virusit KOVID-19.
- Të sigurohen paketa higjienike për të gjithë personat e dënuar.

# BURGU GJEVGJELI

## Të dhëna të përgjithshme

Burgu Gjevgjeli është institucion ndëshkimor-korrektues i llojit gjysmë të hapur në të cilin ekzekutohet dënimi me burgim deri në tre vjet, si dhe dënimi me burgim deri në një vit për përsëritësit e veprave penale të dënuar më parë me burg. Brenda burgut ka edhe një njësi paraburgimi.

Më 24 gusht 2020 u realizua një vizitë një-ditore në Burgun Gjevgjeli. Kapaciteti i Burgut Gjevgjeli është me 43 shtretër për personat e dënuar dhe me 12 për të paraburgosurit. Në kohën e vizitës, aty dënimin e vuanin 24 të dënuar dhe 3 të paraburgosur.

## Kushtet materiale dhe ushtrimi i të drejtave të personave të dënuar

Për sa u përket kapaciteteve të akomodimit, kushteve materiale dhe higjienës, ato ishin kryesisht të kënaqshme. Burgu ka 54 shtretër në pavijonin gjysmë të hapur dhe të hapur, tre shtretër në pavijonin e mbyllur, katër shtretër në njësinë e pritjes dhe një dhomë izolimi me pesë shtretër.

Drejtori theksoi se ai përipiqet që sa më shumë të dënuar të përparojnë dhe të përfshihen në aktivitete pune në burg dhe angazhim pune jashtë burgut. Burgu ka një njësi ekonomike që prodhon ushqim për kafshë dhe një fermë derrash në të cilën janë të angazhuar dy të dënuar. Për më tepër, tre persona janë të angazhuar në kuzhinë, dy në portë, dy në dhomën e kaldajës gjatë dimrit, kurse jashtë institucionit janë të angazhuar tetë persona që marrin 15% të shumës totale.

Për sa u përket kontakteve me botën e jashtme, burgu ka një kabinë telefonike dhe të punësuarit na informuan se ata shpesh i lejojnë të dënuarit t'i përdorin telefonat e tyre zyrtarë që të mund t'i kontaktojnë familjarët e tyre. Vizitat bëhen dy herë në muaj, dhe me kërkesë të personit të dënuar, përveç familjes, vizita mund të realizojnë edhe miqtë me leje paraprake nga drejtori.

## Kujdesi shëndetësor

Burgu nuk ka një mjek të përhershëm burgu që ofron kujdes shëndetësor për personat e dënuar. Burgu ka një dhomë mjekësore për kontrolle ku çdo të martë dhe të premte vjen një mjek dhe ka firmosur një marrëveshje me një ordinancë dentare private për ofrimin e shërbimeve dentare.

## **Ankesat nga të burgosurit dhe ofrimi i ndihmës juridike**

Personat e dënuar nuk shprehën dëshirë për të biseduar me ekipin e monitorimit.

### **Rekomandime:**

- Megjithëse deri më tani nuk ka persona të dënuar në burg të infektuar me virusin KOVID-19, në marrëveshje me ISHP Gjevgjeli të sigurojnë vizita më të shpeshta te mjeku në institucionin (3 herë në javë) në mënyrë që të dënuarit t'i raportojnë në kohë simptomat e virusit KOVID-19.

# BURGU KUMANOVË ME PAVIJON TË HAPUR NË KRIVA PALLANKË

## Të dhëna të përgjithshme

Burgu Kumanovë është një institucion ndëshkimor-korrektues i llojit gjysmë të hapur ku ekezekutohen dënimet me burg në kohëzgjatje deri në tre vjet, si dhe dënim me burg deri në një vit për të burgosurit përsëritës të veprave dhe që më parë kanë qenë të dënuar me burg. Në këtë burg ka edhe njësi paraburgimi.

Ekipi monitorues më 15 shtator 2020 bëri një vizitë një-ditore në Burgun Kumanovë.

Kapaciteti i Burgut Kumanovë është për 226 persona, 178 të burgosur dhe 48 persona të paraburgosur. Ditën e vizitës numri i personave të burgosur ishte 97 persona, prej të cilëve pesë ishin në arrati dhe 18 persona të paraburgosur.

Në këtë institucion ka edhe një krah të veçantë ku janë të akomoduar shtetasit e huaj, numri i të cilëve ditën e vizitës ishte 30. Shtetasit e huaj dënimin e tyre me burg e vuajnë deri në tre vjet. Në burgun ka një pavijon të mbyllur dhe një gjysmë të hapur, kurse pavijoni i hapur gjendet në Kriva Pallankë.

Në burgun ka 75 nëpunës të policisë së burgjeve, nga të cilët shtatë janë gra. Institucioni ka të punësuar dy juristë, katër edukatorë, një infermier dhe një kuzhinier, kurse në marrëveshje me Universitetin Ndërkombëtar Sllav në institucionin bëjnë vizita juristë dhe psikologë të rinj.

## Kushtet materiale dhe ushtrimi i të drejtave të personave të dënuar

Në institucion ka një pavijon gjysmë të hapur, një të mbyllur, qendër pranimit dhe njësi paraburgimi. Pavijoni gjysmë i hapur ka 14 dhoma dhe në ditën e vizitës aty ishin akomoduar 50 persona. Në pavijonin e mbyllur ishin akomoduar gjithsej nëntë persona, kurse në qendrën e pranimit tre persona.

Pothuajse në të gjitha dhomat kishte një nivel shumë të ulët të higjienës, lagështi, mure dhe tavane të dëmtuara, dritare të vogla nga ku pothuajse mezi hynte drita e diellit, si dhe ndriçim të dobët nga llambat e vendosura. Dhomat janë të pajisura me shtretër në kate, dyshekë, çarçafë dhe tualet të papastër, kurse sendet e tyre personale të dënuarit zakonisht i mbajnë në shtretërit e lirë ose në tavolinat, sepse nuk ka dollapë.

Në secilin pavijon kishte një dhomë për aktivitete të përbashkëta të pajisura me një tualet e cila përdorej nga të dënuarit vetëm për të pirë cigare dhe për t'i kryer nevojat fiziologjike.

Problemi kryesor në institucion vazhdon të jetë mungesa e ujit. Gjegjësisht, institucioni me ndihmën e një kompanie që gjendet pranë institucionit e ka zgjidhur vetëm pjesërisht këtë problem, kështu që në burgun aktualisht ka ujë vetëm në tualetet e përbashkëta, por jo edhe në dhoma. Për shkak të kësaj, higjiena në burg është në një nivel shumë të ulët, dhe nga pothuajse të gjitha dhomat përhapet erë e pakëndshme. Të dënuarit deklaruan se nuk kishin as ujë të pijshëm.

Tualetet e përbashkëta janë gjithashtu në gjendje të keqe, kështu që ka vetëm një dush në tualet për shtetasit e huaj dhe personat e akomoduar në pavijonin e mbyllur. Në tualetin tjetër të përbashkët ka vetëm dy dushe, ndërsa burgu ka kapacitet për 226 persona.

Dhomat ku janë akomoduar personat në qeli për izolim në vetmi u gjetën në gjendje shumë të keqe, me një nivel shumë të ulët higjienë, erë të pakëndshme, dyshekë të papastër dhe prani të lagështisë. Në qelitë e izolimit, të dënuarit nuk mundën vetë t'i ndezin dhe fikin dritat, sepse sistemi i menaxhimit të dritave kontrollohet nga personat zyrtarë.

Shëtitorja e destinuar për personat e vendosur në qelitë e izolimit, pavijonin e mbyllur dhe njësinë e paraburgimit është një hapësirë e rrethuar nga një mur betoni në të cilin ekziston vetëm një portë futbollit, për shkak të së cilës u theksua që këta persona nuk kanë mundësi ta kalojnë kohën e tyre të lirë në mënyrë produktive.

Burgu ka gjithashtu dhoma që shërbejnë si: kuzhinë, dhomë ngrënie, punëtori, klasë, dhomë për rite fetare, bibliotekë, palestër dhe dy dhoma për vizita të të dënuarit dhe të paraburgosurit dhe për pastrim rrobash.

Shëtitorja për personat në pavijonin gjysmë të hapur është një hapësirë e gjerë ku ka fushë basketbolli.

Për shkak se kabinat e telefonit të burgut nuk funksionojnë, institucioni ka blerë katër telefona celularë të cilët të dënuarit i kanë në dispozicion çdo ditë në periudhën prej orës 08:00 deri në orën 16:00. Telefonat celularë i mbajnë edukatorët dhe në to është i instaluar aplikacioni "Viber" me qëllim që shtetasit e huaj të mund të kontaktojnë me të afërmit e tyre pa asnjë problem.

Lidhur me angazhimin në punë të të dënuarve, drejtori theksoi se 90% e numrit të përgjithshëm të të burgosurve janë të angazhuar në punë. Shumica e tyre janë të angazhuar në kuadër të burgut, dhe atë: në kuzhinë, në mirëmbajtjen e higjienës dhe sigurisë, ndërsa 10 prej tyre janë të angazhuar jashtë institucionit.

## **Kujdesi shëndetësor**

Kujdesi shëndetësor në burg sigurohet përmes një infermieri i cili është i punësuar në institucion me orar të plotë pune. Burgun e vizitojnë një mjek dy

herë në javë dhe një dentist një herë në dy javë. Në burgun nuk është i punësuar asnjë psikiatër. Institucioni ka një ambulancë për kontrollin e të dënuarve dhe një ordinancë dentare. Në kohën e vizitës, disa të dënuar po prisnin në radhë për kontroll në dhomën e pritjes së ambulancës. Infermieri na njoftoi se ata i kanë të gjitha ilaçet e nevojshme në dispozicion dhe se ata vazhdimisht u japin referime të dënuarve për kontrolle te një mjek specialist, kur kjo është e nevojshme.

### **Ankesat nga të burgosurit dhe ofrimi i ndihmës juridike**

Gjatë vizitës, pesë të dënuarve u është ofruar ndihmë e drejtpërdrejtë juridike për një çështje të caktuar juridike dhe ata u njoftuan me mekanizmat për mbrojtje nga tortura dhe trajtimi çnjerëzor.

Dy shtetas të huaj deklaruan se për shkak se janë shtetas të huaj, ata nuk i shfrytëzojnë privilegjet. Të dytë kërkuan informacion në lidhje me kushtet dhe procedurën e transferimit në vendet e tyre amë për ta vuajtur pjesën e mbetur të dënimit.

Të gjithë personat e dënuar u ankuan se higjiena është në nivel të ulët për shkak të mungesës së ujit në qelitë.

Dy nga të dënuarit kërkuan informacion mbi lirimin e parakohshëm nga institucioni me vendim për lirim me kusht.

Një prej të dënuarve kishte nevojë për një dentist të cilin e pret për një kohë të gjatë, por institucioni na informoi se pritja është rezultat i respektimit të protokolleve për parandalimin e pandemisë së shkaktuar nga KOVID-19, por që së shpejti do të ekzaminohej në një ordinancë dentare.

### **Rekomandime:**

- Të gjendet një zgjidhje afatgjatë për problemin e furnizimit me ujë që në kushtet e pandemisë së virusit KOVID-19 mund të konsiderohet gjithashtu si një mjet i trajtimit çnjerëzor të të dënuarve që mund të kontribuojë në përkeqësimin e shëndetit të tyre fizik dhe mendor.
- Të vendoset një sistem kontrolli të ndriçimit në qelitë e izolimit, pasi ndiçimi është nën kontrollin e nëpunësve zyrtarë.
- Të pajiset shëtitorja me rekuizita për të dënuarit në izolim, në pavijonin e mbyllur dhe në njësinë e paraburgimit.
- Të angazhohen me punë personat e dënuar në kuadër të burgut.

# PAVIJONI I HAPUR NË KRIVA PALLANKË NË KUADËR TË BURGUT KUMANOVË

## Të dhëna të përgjithshme

Ekipi monitorues më 25 shtator 2020 kreu një vizitë një-ditore në Pavijonin e hapur të Burgut Kumanovë në Kriva Pallankë.

Pavijoni i hapur i Burgut Kumanovë ndodhet në një ndërtesë të vjetër në dy kate në Kriva Pallankë. Objekti ka kapacitet për 23 persona, dhe në kohën e vizitës në burg, dënimin me burg po e vuanin katër persona. Njëri nga të dënuarit është i punësuar në kuzhinë, një tjetër angazhohet sipas nevojës, ndërsa dy të tjerët nuk janë në gjendje të punojnë për shkak të moshës dhe shëndetit të tyre.

Institucioni ka gjithsej shtatë punonjës, nga të cilët pesë janë nëpunës policor me uniformë dhe dy janë punonjës në pjesën administrative. Risocializimi në Pavijonin e hapur të Burgut Kumanovë në Kriva Pallankë kryhet nga udhëheqësi i departamentit i cili theksoi se për shkak të numrit të vogël të të dënuarve, risocializimi kryhet përmes punës individuale me personat, kurse intensiteti varet nga nevojat.

## Kushtet materiale dhe ushtrimi i të drejtave të personave të dënuar

Institucioni ka gjithsej katër dhoma. Në kohën e vizitës, dënimin me burg po e vuanin katër persona të cilët ishin akomoduar në dy dhoma. Dhomat ishin të rregulluara relativisht mirë, me dritare të mëdha nga ku hyn drita e diellit. Dhomat ishin pajisur me shtretër dhe dollapë për ruajtjen e sendeve personale.

Në katin e sipërm ka një tualet të përbashkët i cili ishte në nivel shumë të ulët të higjienës. Si një gjë pozitive, udhëheqësi theksoi se në periudhën e kaluar ai ishte meremetuar, respektivisht ishin vendosur pllaka të reja. Në tualetin gjithashtu kishte dhe një pasqyrë e cila ishte e thyer në skajet dhe paraqiste një mundësi për (vetë)lëndim. Pasi u bë një vërejtje nga ekipi i monitorimit, pasqyra u përjashtua.

Kuzhina dhe dhoma e ngrënies ku shërbehej ushqimi ishin relativisht të rregullta dhe të pastra, dhe në dhomën e ngrënies u vu re se kishte një kuti për pranimin e ankesave nga Avokati i Popullit e cila nuk ishte e kyçur.

Në pjesën e jashtme të institucionit, pra në katin e dytë, duhet menjëherë të vendoset një gardh mbrojtës, përndryshe siguria e të dënuarve dhe zyrtarëve në institucionin do të vazhdojë të jetë në rrezik.

Palestra në institucionin ka pajisje të improvizuara për shkak të të cilave

ekziston rreziku i aksidenteve për personat e dënuar.

### **Kujdesi shëndetësor**

Pavijoni i hapur në INK Kumanovë në Kriva Pallankë nuk posedon asnjë automjet zyrtar. Në këtë institucion ka automjete që janë jashtë përdorimit dhe një automjet që për momentin është me targa të Kumanovës për shkak të së cilës po pritet skadimi i regjistrimit që të mund të regjistrohet dhe të përdoret nga zyrtarët e departamentit të hapur të Burgut Kumanovë në Kriva Pallanka. Për shkak të kësaj, për nevoja zyrtare punonjësit e institucionit i përdorin automjetet e tyre private, të cilat zakonisht përdoren për transferimin e të dënuarve në Qendrën shëndetësore, sepse institucioni nuk ka mjek të punësuar.

Udhëheqësi i departamentit theksoi se terapia e të dënuarve shpërndahet në atë mënyrë që ata nënshkruhen kur i marrin ilaçet e tyre.

### **Ankesat nga të burgosurit dhe ofrimi i ndihmës juridike**

Gjatë kohës së vizitës, tre të dënuarve u është ofruar ndihmë e drejtpërdrejtë juridike në lidhje me një çështje të caktuar juridike dhe personat janë njohur me mekanizmat për mbrojtje nga tortura dhe trajtimi çnjerëzor.

Njëri nga personat e dënuar na informoi se për herë të parë e vuan dënimin me burg dhe nuk është i njoftuar me ligjet, për shkak të së cilës lind nevoja që zyrtarët t'i informojnë të dënuarit për të drejtat dhe obligimet e tyre, dhe ata mund ta bëjnë këtë duke i bërë publike të drejtat e tyre përmes afisheve dhe broshurave në ambientet e institucionit.

### **Rekomandime:**

- Të meremetohet tualeti i përbashkët.
- Të vendoset një gardh mbrojtës në pjesën e jashtme të katit të dytë.  
Të vendoset çelës në kutinë për pranimin e ankesave nga ana e Avokatit të Popullit.
- Të punësohet një mjek në institucionin.  
Të informohen personat e dënuar për të drejtat e tyre përmes broshurave, afisheve dhe të ngjashme, të cilët do të vendosen në vende publike në institucionin.

Me ndihmën e autoriteteve lokale ka nevojë për meremetimin e rrugës para hyrjes në institucionin, e cila në fakt është një urë me dërrasa druri mbi vetë lumin dhe paraqet rrezik për sigurinë e të gjithë njerëzve që kalojnë mbi të.



# BURGU OHËR/SHTËPIA EDUKATIVO-KORREKTUESE TETOVË

## Të dhëna të përgjithshme

Sipas rrjetit të institucioneve ndëshkimore-korrektuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Burgu Ohër funksionon si institucion ku zbatohen dënimet me burg për fëmijë. Në Burgun Ohër drejtohen persona meshkuj të mitur dhe të rritur të ri, që janë të dënuar me aktgjykim të plotëfuqishëm me dënim me burg për fëmijë.

Gjithashtu, për momentin në Burgun Ohër janë akomoduar edhe fëmijët e mbrojtur të Shtëpiës edukativo-korrektuese Tetovë të cilëve u është shqiptuar masa edukativo-korrektuese për në shtëpi edukativo-korrektuese në përputhje me Ligjin për drejtësi të fëmijëve<sup>6</sup>.

Në këtë institucion ka edhe njësi paraburgimi.

Ekipi monitorues më 11 shtator 2020 kreu një vizitë një-ditore në Burgun Ohër. Një vizitë shtesë në burgun u realizua më 1 tetor. Në përputhje me metodologjinë për vizitat monitoruese, u zhvillua një bisedë me drejtorin e Burgut Ohër, pas së cilës vijoi inspektimi i ambienteve të burgut dhe intervistat individuale me fëmijët.

Burgu Ohër ka kapacitet për 18 persona në njësinë e paraburgimit dhe rreth 35 persona në pjesën tjetër. Në kohën e vizitës, vuajtjen e dënimit me burg për fëmijë po e vuanin pesë persona, ndërsa dhjetë fëmijë e vuanin masën referim në shtëpi edukativo-korrektuese.

Në Burgun Ohër janë të punësuar 23 nëpunës të policisë së burgut, nga të cilët vetëm dy janë gra, ndërsa institucioni ka vetëm dy edukatore që punojnë me fëmijët.

## Kushtet materiale dhe ushtrimi i të drejtave të personave të dënuar

Sa u përket kapaciteteve të akomodimit dhe higjienës, fëmijët janë ndarë në blloqe të ndryshme, varësisht nga fakti nëse vuajnë dënim me burg apo masë referimi në shtëpi edukativo-korrektuese.

Në këtë institucion ka gjithsej gjashtë dhoma në pjesën për vuajtjen e dënimit me burg dhe për masën edukativo-korrektuese referim në shtëpi edukativo-korrektuese. Dhomat janë të pajisura me shtretër, dollapë, televizor dhe dritare të mëdha nga ku hyn drita e diellit. Pothuajse në të gjitha dhomat janë vërejtur lagështi, dyshekë të dëmtuar dhe mure të rrënuara.

<sup>6</sup> Ligji për drejtësi për fëmijë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” Nr. 148/2013 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” Nr. 152/2019 dhe 275/2019).

Drejtori na njoftoi se me ndihmën e donacioneve, u blenë disa televizorë, por ato shpesh here janë shkatërruar nga fëmijët.

Në institucionin ekziston edhe një palestër e improvizuar, për të cilën disa nga fëmijët e shprehën shqetësimin e tyre se mund të lëndohen për shkak të mosfunksionimit të pajisjeve.

Tualeti i përbashkët ka tre dushe që janë në gjendje të keqe dhe pa perde.

Për sa i përket ushqimit, institucioni ka punësuar një kuzhinier të cilin e ndihmojnë një pjesë e fëmijëve. Disa nga fëmijët deklaruan se nuk janë të kënaqur me ushqimin për shkak të së cilës ata më shumë herë janë ankuar tek drejtori i institucionit.

Kur bëhet fjalë për programet e trajtimit dhe aktivitetet e kohës së lirë, nga vizita arritëm në përfundimin se fëmijët e privuar nga liria nuk kanë kushte adekuate për zbatimin e aktiviteteve dhe programeve për arsim, sport, rekreacion dhe veprimtari profesionale. Oborri i institucionit ku fëmijët e kalojnë kohën jashtë dhomave është i betonizuar dhe ndahet nga një gardh alumini, duke i ndarë dy kategoritë e fëmijëve të privuar nga liria. Oborri nuk është i pajisur për t'ua mundësuar fëmijëve të privuar nga liria aktivitetet e tyre rekreative dhe ata thanë se nuk kanë as topa për të luajtur basketboll, futboll, etj.

Institucioni ka punësuar vetëm dy edukatore, domethënë, sipas situatës aktuale, ka një edukatore për shtatë fëmijë të privuar nga liria, të cilat punojnë në dy ndërrime, nga ora 07:30 deri në orën 15:30 dhe nga ora 15:30 deri në orën 20:30. Edukatorët theksuan se nuk mund të arrijnë t'u kushtojnë vëmendje të mjaftueshme të gjithë fëmijëve. Ato me fëmijët punojnë vetëm individualisht dhe shumë pak punë dhe aktivitete bëhen në grup. Drejtori theksoi se në institucionin vetëm dy herë gjatë tre viteve të kaluara kanë ardhur përfaqësues nga Qendra për punë sociale, kurse gjykatës nuk kanë ardhur asnjëherë.

Sa i përket qasjes në arsim, u konkludua se deri në mars të vitit 2020, para shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme të shkaktuar nga virusi COVID-19, në institucion janë mbajtur orë mësimore në lëndët të gjuhës maqedonase, gjuhës anglishte dhe në matematikë. Mësuesit e këtyre lëndëve kanë ardhur në shkollë tri herë në javë. Pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, fëmijët kanë vazhduar t'i ndjekin mësimet në këto lëndë tri herë në javë në internet. Orët i kanë mbajtur përmes një kompjuteri të lidhur me një televizor. Përmbajtja shkencore që u mësohej fëmijëve ka qenë e dedikuar për arsimin fillor, kurse për arsimin e mesëm nuk ka pasur fare mësim, gjë që e vërejmë si një mangësi sepse 90% e personave në institucionin janë të rritur, kështu që disa prej tyre fare nuk i kanë ndjekur mësimet. Pas përfundimit të orëve, personat i kanë mbajtur provimet për lëndët me prezencë fizike në ambientet e institucionit. Është vërejtur se në institucion nuk ka bibliotekë, për të

cilën drejtori deklaroi se disa nga personat nuk dinë të lexojnë. Në lidhje me kontaktet me botën e jashtme, drejtori i institucionit theksoi se fëmijët e privuar nga liria rrallë vizitohen nga familjet e tyre dhe shprehu shqetësim për këtë situatë. Fëmijët na njoftuan se institucioni ka një kabinë telefonike që nuk funksionon mirë, kështu që derisa ata arrijnë t'i kontaktojnë të afërmit e tyre, shpenzojnë shumë më tepër nga kredia e tyre, të cilën e paguajnë vetë.

## **Kujdesi shëndetësor**

Sa i përket kujdesit shëndetësor të fëmijëve, u theksua se nuk ka personel të përhershëm mjekësor në institucionin. Drejtori na informoi se në burgun një herë në javë vjen një mjek i përgjithshëm. Nëse një fëmijë i dënuar, respektivisht një person i cili vuan një masë edukativo-korrektuese ka nevojë për një psikiatër ose një dentist, ai/ajo dërgohet jashtë institucionit.

## **Ankesat e fëmijëve që e vuajnë dënimin me burg ose të cilëve u është shqiptuar masa e referimit në shtëpi edukativo-korrektuese dhe ofrimi i ndihmës juridike**

Gjatë vizitës së katër fëmijëve që e vuajnë dënimin me burg dhe gjashtë fëmijëve që e vuajnë masën e referimit në shtëpi edukativo-korrektuese u është ofruar ndihmë e drejtpërdrejtë juridike në lidhje me ndonjë çështje të caktuar juridike dhe u njoftuan me mekanizmat për mbrojtje nga tortura dhe trajtimi çnjerëzor.

Një vërejtje e përgjithshme nga shumica e fëmijëve të intervistuar si dhe nga zyrtarët e institucionit është se institucioni nuk i plotëson kërkesat për këtë qëllim. Fëmijët nuk kanë hapësira për aktivitete fizike, përveç palestrës e cila është në gjendje të keqe dhe fushës së futbollit e cila është e ndarë në gjysmë, ku një pjesë është për fëmijët që e vuajnë dënimin me burg dhe pjesa tjetër për fëmijët që e vuajnë masën edukativo-korrektuese referim në shtëpi edukativo-korrektuese.

Ekipi i Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe Shoqata e Avokatëve të Rinj të Maqedonisë vuri në dukje se nuk ka kushte për akomodim alternativ për fëmijët dhe/ose ndonjë mënyrë për t'i shmangur kontaktet në institucionin që duhet të sigurohen nga institucioni në kushtet e pandemisë. Akomodimi i vetëm alternativ është pjesa e izolimit e vendosur afër njësisë së paraburgimit ku për shkaqe sigurie personat mund të akomodohen maksimalisht deri në shtatë ditë. Gjatë vizitës nuk na u lejua inspektimi i këtyre ambienteve. Arsyeimi i drejtorit të institucionit ishte se për këtë nevojitet vendim nga gjykata.

Dy fëmijë të dënuar me burg raportuan se mbi ta është ushtruar dhunë fizike

nga ana e një nëpunës i policisë së burgut. Personave ua kanë goditur kokët me derën e qelisë, kanë qenë të goditur me çelës francez dhe në shpinë me ndonjë objekt. Ata treguan plaga të dukshme në shpinë të cilat përfaqësojnë indikacione se ata kanë pësuar dhunë. Në periudhën e mëparshme, këtyre personave u është dhënë ndihmë mjekësore nga një mjek. Ata disa herë i kanë raportuar drejtorit se kanë pësuar dhunë, por deri më tani kjo ska pasur ndonjë rezultat. Për më tepër, gjatë bisedës, ata kërkuan që menjëherë të thirret një mjek, sepse një ditë më parë kishin pësuar dhunë dhe nuk ndiheshin mirë. Kjo kërkesë iu përcoll drejtorit, i cili, pas një bisede telefonike me një nga policët e burgjeve, tha se ata e kishin ndryshuar deklaratën e tyre dhe se nuk kishin më nevojë për mjek.

Dhunë e kohëpaskohshme dhe përdorim i forcës nga ana e policisë së burgut raportuan edhe disa persona të tjerë. Ata nuk i kanë denoncuar nga frika se në të ardhmen do të përballen me dhunë më të rëndë. Ekipi i Shoqatës së Juristëve të Rinj të Maqedonisë dhe Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut e informuan Drejtorinë për Ekzekutimin e Sanksioneve për të ndërmarrë mbikëqyrje të jashtëzakonshme në mënyrë që t'i hetojnë rrethanat e rastit dhe t'i marrin masat e duhura në rast të përdorimit të forcës nga një përfaqësues i policisë së burgut.

Pas dhunës së raportuar ndaj fëmijëve në Drejtorinë për Ekzekutimin e Sanksioneve, më 16 shtator 2020 në buletin e Ministrisë së Punëve të Brendshme u botua si vijon: Më 15 shtator 2020 në orën 10:45 në SPB Ohër, një person i punësuar në institucionin ndëshkimor-korrektues Burgu Ohër, së bashku me një 19-vjeçar nga Strumica i cili vuan një dënim në burg, kanë raportuar se më 9 shtator 2020, rreth orës 3:00 të mëngjesit, të dënuarit Ç. dhe S. hynë me forcë në dhomën e 19-vjeçarit dhe kishin tentuar të bëjnë marrëdhënie seksuale me të. Për rastin ishte njoftuar prokurori publik dhe po merren masa për zbardhjen e rastit. E njëjta ngjarje nuk iu raportua aspak ekipit gjatë vizitës në 13 shtator 2020. Përkundrazi, ekipit iu njoftua se gjatë periudhës së kaluar nuk ka pasur ndonjë problem i madh, madje as ankesa nga ndonjë individ në lidhje me përdorimin e tepruar të forcës nga ana e policisë së burgut.

Në një vizitë shtesë që u realizua më 1 tetor 2020, u konstatua se një fëmijë i cili ndërkohë e ka arritur moshën madhore u transferua në ShNK Shtip, dhe fëmija tjetër e ndryshoi deklaratën e dhënë më parë dhe tregoi se ata ia bënë dëmtimet njëri-tjetrit për t'ia mveshur fajin institucionit.<sup>7</sup>

Ne kërkojmë që rasti të hetohet dhe të merren masat përkatëse, sepse nëse ndaj të gjithë personave që raportojnë dhunë reagohej në këtë mënyrë, atëherë vihet në pikëpyetje i gjithë sistemi për raportimin dhe luftimin e torturës dhe trajtimit çnjerëzor në burgje.

---

<sup>7</sup> Më 9 tetor 2020, është planifikuar një vizitë shtesë në ShNK Shtip për të zhvilluar një bisedë me personin i cili ishte transferuar. Më 6 tetor 2020 nga drejtori i ShNK Shtip jemi të informuar se institucioni i ndalon të gjitha vizitat për një kohë të caktuar për shkak të një punonjësi dhe një personi të dënuar, të sëmurë nga COVID-19. Nëse bëhet fjalë për një vizitë urgjente, ne jemi të informuar se ekziston mundësia për të kryer një bisedë me personin përmes video konferencës.

Në institucion gjendet një fëmijë që e vuan masën e referimit në shtëpi edukativo-korrektuese dhe është me aftësi të kufizuara intelektuale, për të cilin nevojitet një kujdes i veçantë. I njëjti po vuan dhunë fizike dhe psikike nga personat e tjerë që vuajnë dënim në këtë institucion.

### **Rekomandime:**

- Të merren aktivitete për akomodimin e fëmijëve që vuajnë dënim me burg për fëmijë, në një institucion që do të jetë i përshtatshëm për nevojat e tyre, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

### **Derisa të transferohen fëmijët në objekte të tjera, duhet që:**

- Të zbatohen mbikëqyrje më të shpeshta inspektuese në institucion nga ana e Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve.
- Të punësohet një mjek në institucion i cili do ta ndjek rregullisht gjendjen psiko-fizike të fëmijëve.
- Të angazhohet një psikiatër në institucion.
- Të implementohet arsimi fillor dhe i mesëm.
- Të sigurohen kushte për sport, rekreacion dhe kulturë për fëmijët.
- Të merremetohen tualetet e përbashkëta.
- Të regjistrohen të gjitha rastet e përdorimit të forcës dhe mjeteve të dhunës, respektivisht edhe ato që kanë ndodhur me rastin e kacafytjes midis personave të privuar nga liria dhe ata të adresohen në institucionet kompetente.

# BURGU SHKUP

## Të dhëna të përgjithshme

Burgu Shkup është institucion i llojit gjysmë të hapur në të cilin zbatohet dënimi me burg me kohëzgjatje deri në tre vjet, si dhe dënimi me burg deri në një vit për përsëritësit e veprave penale të dënuara më parë me burg. Burgu ka një njësi paraburgimi, e cila është njësi më e madhe për paraburgim në vendin.

Më 4 gusht 2020, u bë një vizitë një-ditore në Burgun Shkup. Një vizitë shtesë për t'u ofruar ndihmë juridike personave të dënuar u realizua më 29 shtator 2020. Lidhur me numrin dhe kapacitetin e institucionit, nga biseda me udhëheqësin e departamentit për risocializim u konstatua se burgu ka kapacitet për 310 shtretër për personat që vuajnë masë paraburgimi dhe 128 shtretër për persona të dënuar. Në kohën e vizitës, u gjetën 205 persona të paraburgosur (nga të cilat 10 janë gra të paraburgosura) dhe 82 persona që e vuajnë dënimin me burg.

## Kushtet materiale dhe ushtrimi i të drejtave të personave të dënuar

Për sa u përket kapaciteteve akomoduese, kushteve materiale dhe higjienës, lagështisë, erës, ushqimit dhe ajrosjes joadekuate, këto janë fenomene të pranishëm në shumicën prej dhomave që i vizituam. Dhjetë dhoma në njësinë e paraburgimit "Pavijoni B" ishin rinovuar përmes donacioneve të mbledhura nga drejtori i institucionit.

Gjatë vizitës, drejtori na informoi se të dënuarit janë të angazhuar me punë, zakonisht në mirëmbajtjen e higjienës në burg (mbajtës së rendit, etj.). Burgu ka të punësuar dy instruktorë, një instruktor për zdrucktari dhe një instruktor bravandreqës. Fatkeqësisht, problemi me pasivitetin e burimeve ekzistuese për punësimin e të dënuarve siç janë punëtorja e mekanikëve të makinave, bujqësia në njësinë ekonomike të burgut dhe kuzhina, është ende i pranishëm.

## Kujdesi shëndetësor

Sa i përket kujdesit shëndetësor, Burgu Shkup në kohën e vizitës kishte dy infermiere, një mjek të përgjithshëm, një psikiatër dhe një psikolog. U theksua se problemi kryesor sa i përket kujdesit shëndetësor është qasja në shërbimet dentare, për të cilën personat e dënuar janë ankuar më së shumti.

## Ankesat nga të burgosurit dhe ofrimi i ndihmës juridike

Gjatë vizitës, tetë të dënuarve u është ofruar ndihmë e drejtpërdrejtë juridike në lidhje me një çështje të caktuar juridike dhe u njoftuan me mekanizmat për mbrojtjen nga tortura dhe trajtimi çnjerëzor.

Si një ankesë e përgjithshme nga të dënuarit, u vu në dukje vonesa e pagesës së kompensimit të punës që u takon të dënuarve në përputhje me nenin 31 të Rregullores për rregullat e shtëpisë për personat e dënuar që vuajnë një dënim me burg në një institucion ndëshkimore-korrektues.

Nga ana e disa personave të dënuar që trajtohen me terapi me metadon deklaruan se për shkak se terapia e tyre u shpërndahet publikisht para të burgosurve të tjerë, ata janë të ekspozuar ndaj keqtrajtimeve nga të burgosurit e tjerë dhe se është shkelur e drejta e tyre për privatësi. Institucioni duhet ta merr parasysh mbrojtjen e së drejtës për privatësi të të dënuarve dhe t'u japë atyre terapi në një vend ku do të respektohet anonimiteti i personave. Për më tepër, ata theksuan se në burgun një pjesë e mirë e njerëzve me terapi me metadon janë të angazhuar në pastrimin e tualeteve dhe dyshemeve, mbeturinave, etj., megjithëse disa prej tyre kanë aftësi artizanale që mund të përdoren nga ana e institucionit. Institucioni duhet ta merr parasysh aftësimin profesional të të dënuarve për t'i angazhuar në përputhje me aftësitë e tyre dhe në përputhje me kapacitetet e tyre.

Ankesa tjetër e ngritur nga disa prej të dënuarve ishte se për të parashtruar një kërkesë për lirim me kusht nga institucioni pritet një periudhë e gjatë dhe se gjykatat nuk i marrin parasysh gjendjet e tyre shëndetësore, si dhe rrethanat e tjera dhe si rezultat i kësaj, këto kërkesa zakonisht refuzohen.

Disa persona të dënuar që nuk ishin të kënaqur me ushqimin ngritën ankesa në lidhje me të.

Gjatë vizitës shtesë të realizuar më 29 shtator 2020, pesë të dënuarve u është ofruar ndihmë e drejtpërdrejtë juridike në lidhje me një çështje të caktuar juridike dhe janë njoftuar me mekanizmat për mbrojtje nga tortura dhe trajtimi çnjerëzor.

Gjatë vizitës shtesë, disa persona të dënuar deklaruan se po përballeshin me një problem në lidhje me kujdesin shëndetësor dhe se këto probleme nuk ishin raportuar nga ana e institucionit në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore. Dy të dënuar u ankuan se kur kanë vizituar një mjek gjatë përdorimit të privilegjit - mungesë nga institucioni, ata kanë paguar privatisht, sepse nuk kanë pasur sigurim shëndetësor. Nga ana e institucionit u informuam se teknikisht është e pamundur të regjistrohen për sigurim shëndetësor personat e dënuar që janë pranuar në institucion para 1 korrikut 2019, që paraqet një problem të madh për ta dhe për të drejtën e tyre të sigurimit shëndetësor.

### **Rekomandime:**

- Të pajisen dhe mirëmbahen në mënyrë adekuate ambientet me qëllim që t'i plotësojnë kushtet e nevojshme që personat e dënuar të mund ta vuajnë dënimin me burg.
- Duke i shfrytëzuar resurset ekzistuese, të angazhohen në punë personat e dënuar në kuadër të burgut.
- Të bëhen përpjekje për të angazhuar një dentist në burg.
- Të mbrohet privatësia e personave të dënuar sa i përket përdorimit të terapisë mjekësore.



# BURGU STRUMICË

## Të dhëna të përgjithshme

Burgu Strumicë është një institucion gjysmë i hapur në të cilin zbatohet dënimi me burg deri në tre vjet, si dhe dënimi me burg deri në një vit për përsëritësit e veprave penale të dënuara më parë me burg. Në këtë burg dënimin me burg e vuajnë persona nga Strumica, Koçani, Shtipi, Vinica, Dellçeva, Berova dhe Radovishi.

Më 20 gusht 2020 u realizua një vizitë në terren në Burgun Strumicë.

Kapaciteti i përgjithshëm i Burgut Strumicë është për 77 persona. Në ditën e vizitës, dënim vuanin 59 persona, të shpërndarë në pavijonet A, B dhe V.

## Kushtet materiale dhe ushtrimi i të drejtave të personave të dënuar

Për sa u përket kapaciteteve të akomodimit, kushteve materiale dhe higjienës, të gjitha dhomat ishin të pajisura me shtretër në kate, tavolinë, karrige dhe dollapë metalikë të dedikuar për t'i ruajtur sendet personale të të dënuarve. Në secilën dhomë ka televizorë, të sjellë nga vetë personat e dënuar. Të gjitha qelitë kanë dritë të mjaftueshme, me dritare të mëdha që e lejojnë ajrosjen e ambienteve.

Nëpër qelitë nuk ka erë lagështie. Drejtori na informoi se muret janë ngjyrosur një muaj para vizitës sonë. Çarçafët e krevateve janë të pastër, dyshekët janë në gjendje të mirë. Për higjienën në qelitë kujdesen të dënuarit dhe në kohën e vizitës pastërtia ishte në një nivel të kënaqshëm.

Në katin e sipërm, ku ndodhen qelitë, ka dy tualete me tre lavamanë dhe tre tualete, ku ndjehej era e lagështisë dhe higjiena ishte me nivel të ulët. Për mirëmbajtjen e higjienës në këto ambiente kujdesen personat e dënuar. Në tualetet, të dënuarit i kanë shënuar çezmat nga të cilat mund të pihet ujë.

Burgu ka edhe hapësirë për larjen e rrobave, ku me punë është angazhuar një person i dënuar.

Në burg ka edhe një dhomë për mirëmbajtjen e ngrohjes, ku janë akomoduar tre të dënuar që flenë pranë ngrohjes prej ku ndihet erë naftë. Dhoma nuk kishte ventilim të mirë për ta pastruar ajrin.

Lidhur me aktivitetet e lira dhe angazhimin me punë të të dënuarve, oborri ka një sipërfaqe mjaftueshëm të madhe, duke e pasur parasysh numrin e të dënuarve që vuajnë dënim me burg në Burgun Strumicë. Ka bar, instalime druri të mbuluara dhe me stole, shesh lojërash dhe palestër të improvizuar. Në oborrin e burgut ka edhe fermë, për të cilën kujdeset një person i dënuar.

Për sa u përket kontakteve me botën e jashtme, vizitat bëhen në një dhomë për vizita në oborrin e burgut, nga ora 10 e mëngjesit deri në orën 2 të pasdites.

Ekipi i monitorimit nuk ka vërejtur kabina telefonike në Burgun Strumicë.

### **Kujdesi shëndetësor**

Kujdesi shëndetësor në burg sigurohet nga një mjek i përgjithshëm dhe një infermiere që vijnë dy herë në javë. Drejtori i Burgut Strumicë na informoi se nuk ka asnjë problem me furnizimin me ilaçe. Në Burgun Strumicë nuk ka ordinancë dentare, kurse shpenzimet dentare i paguajnë personat e dënuar. Në kohën e vizitës, në ambientet e burgut kishte tre persona me varësi nga drogat, të cilët trajtohen me metadon. Terapia ditore me metadon u jepet nga mbikëqyrësi, dhe metadoni ruhet nga policët kujdestarë.

### **Ankesat nga të burgosurit dhe ofrimi i ndihmës juridike**

Personat e dënuar nuk kanë shprehur dëshirë për të biseduar me ekipin e monitorimit.

### **Rekomandime:**

- Të sigurohet kabinë telefonike me qëllim që të zhvillohet kontakt i pandërprerë i personave të dënuar me botën e jashtme.
- Të bëhen përpjekje për të angazhuar një dentist dhe shërbimet dentare të mbulohen nga ana e institucionit, e jo nga personat e dënuar.

# BURGU TETOVË

## Të dhëna të përgjithshme

Burgu Tetovë është një institucion gjysmë i hapur në të cilin zbatohet burgimi me kohëzgjatje deri në tre vjet, si dhe burgimi me kohëzgjatje deri në një vit për përsëritësit e veprave penale të dënuar më parë me burg. Në këtë institucion ka pavijon të hapur dhe të mbyllur.

Njësia e paraburgimit është mbyllur në vitin 2018.

Në këtë institucion ekziston një hapësirë që përdoret si njësi pritjeje. Burgu nuk ka dhomë të veçantë për vuajtjen e masës disiplinore – izolim në qeli, kështu që për ta zbatuar këtë masë, përdoret një dhomë në katin përdhës të ndërtesës, ku deri në vitin 2018 ndodhej njësia e paraburgimit.

Më 13 gusht 2020 u realizua një vizitë një-ditore në Burgun Tetovë. Kapaciteti i përgjithshëm i Burgut Tetovë është për 48 persona. Në ditën e vizitës, aty ishin të akomoduar 48 të burgosur.

## Kushtet materiale dhe ushtrimi i të drejtave të personave të dënuar

Të gjitha dhomat në institucion janë të pajisura me shtretër në kate, një tavolinë, një karrige dhe dollapë metalikë të destinuar për ruajtjen e sendeve personale të personave të dënuar. Në secilën dhomë ka televizorë, të sjellë nga vetë të dënuarit. Në dy prej tyre ka televizor LED, dhe në dhomat e tjera ka televizorë më të vjetër. Të gjitha qelitë kanë dritë të mjaftueshme që hyn përmes dy dritareve të mëdha, duke e mundur ajrosjen dhe ventilimin.

Në qelitë nuk vjen ere lagështie, kurse muret janë të ngjyrosur. Çarçafët e shtretërve janë të pastër, dyshekët janë në gjendje të mirë. Për higjienën nëpër qelitë kujdesen të dënuarit dhe në kohën e vizitës pastërtia ishte në një nivel të kënaqshëm.

Nëpër korridorët ndihej era e lagështisë. Në katin e sipërm, ku ndodhen qelitë, ka dy tualete me dy lavamanë dhe tualete, ndihet era e lagështisë, është papastër dhe është ftohtë.

Në pjesën e jashtme të burgut, ku ndodhet oborri, ka një dhomë me tre dushe të mbyllura me perde dhe një hapësirë për larjen e rrobave. Në hapësirën për larjen e rrobave është angazhuar me punë një person i dënuar. Hapësira është në gjendje të keqe, është e papastër dhe e ftohtë. Për mirëmbajtjen e higjienës në këtë hapësirë janë përgjegjës personat e dënuar.

Për sa u përket aktiviteteve të kohës së lirë dhe kontakteve me botën e jashtme, të dënuarit i përdorin qelitë e tyre vetëm për të fjetur dhe pjesën tjetër të ditës e kalojnë jashtë në oborrin e burgut. Oborri ka një sipërfaqe të vogël, duke e pasur parasysh numrin e të dënuarve që e vuajnë dënimin me

burg në Burgun Tetovë. Në këtë pjesë të burgut ndodhet edhe një dhomë që të burgosurit e përdorin si palestër me pajisje që i kanë bërë vetë. Të burgosurit gjithashtu kanë një dhomë që e përdorin si bibliotekë, por është e pajisur me pak libra. Në kohën e vizitës, disa të dënuar po luanin shah në atë dhomë. Në këtë dhomë ndodhet edhe kutia në të cilën të dënuarit i parashtrajnë ankesat te Avokati i Popullit. Pranë dhomës me kabinat e dushit dhe makinat për larjen e rrobave, ka një dhomë që funksionon si një "kafene" e mirëmbajtur nga një i dënuar, ku të dënuarit e kalojnë pjesën më të madhe të kohës.

Dhoma të veçanta për vizita nuk ka. Vizitat bëhen në oborrin e burgut. Ekipi i monitorimit nuk vuri re të ketë ndonjë kabinë telefonike në Burgun Tetovë dhe u konstatua se të dënuarit i përdorin celularët e tyre, përkundër faktit se futja dhe përdorimi i një telefoni celular përbën shkelje disiplinore.

Rreth 10 persona të dënuar janë të angazhuar me punë në ndërmarrje private jashtë burgut, në fushën e hotelierisë, prodhimit e mobiljeve, ordianca mjekësore dhe dentare. Sigurimi shëndetësor është siguruar nga burgu dhe ndërmarrjet nuk i paguajnë kontributet e tjera për të dënuarit e punësuar.

## **Kujdesi shëndetësor**

Për sa i përket kujdesit shëndetësor, burgu ka një mjek të përgjithshëm i cili është në institucion çdo ditë nga ora 7:30 deri në orën 15:30 dhe është i disponueshëm për thirrje deri në orën 22:00. Nëse ka nevojë për mjek pas orës 22:00, atëherë vjen Ndihma e Shpejtë. Në institucion nuk ka asnjë infermiere. Dhoma që mjeku e përdor për kontroll dhe për sigurimin e kujdesit shëndetësor është e vogël, ka vetëm një shtrat dhe dy dollapë për ruajtjen e ilaçeve.

## **Ankesat nga të burgosurit dhe ofrimi i ndihmës juridike**

Gjatë vizitës, 11 të dënuarve u është ofruar ndihmë e drejtpërdrejtë juridike për një çështje të caktuar juridike dhe janë njoftuar me mekanizmat për mbrojtje nga tortura dhe trajtimi çnjerëzor.

Ankesa më e madhe nga ana e të dënuarve i referohej ushqimit të shërbyer në institucion. Gjegjësisht, ai është i papërshtatshëm për njerëzit që kanë sëmundje të zëmrës, diabet dhe sëmundje të tjera kronike. Si problem shtesë paraqitet edhe fakti që nëse ushqimi në institucionin silllet nga jashtë, nuk ka kushte për ruajtjen e tij për shkak të mungesës së frigoriferëve. Edhe personat e tjerë që nuk kanë sëmundje kronike gjithashtu u ankuan se ushqimi ishte i një cilësie të dobët dhe i pamjaftueshëm për personat e dënuar.

Gjithashtu, një ankesë e përgjithshme i referohet qasjes së personave në kujdesin shëndetësor, sepse ata nuk janë të regjistruar në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore. Nga ana e institucionit u informuam se ky problem

tashmë është tejkaluar dhe se të gjithë personat janë të regjistruar për sigurim shëndetësor. Sidoqoftë, problemi kryesor i raportuar nga të dënuarit është se pothuajse të gjitha barnat blihen privatisht dhe nuk sigurohen nga institucioni, kështu që të dënuarit janë të detyruar t'i blejnë ato privatisht. Ky është një problem i madh për disa të dënuar që nuk kanë fonde të mjaftueshme për t'i blerë ilaçet e nevojshme.

Më tej, u ngrit një ankesë në lidhje me mirëmbajtjen e higjienës në institucion, respektivisht për faktin se të dënuarve rrallë u jepen mjete higjienike. Si rezultat, ambientet janë shumë të ndyra, që vereheshte edhe në ditën e vizitës.

Disa nga të dënuarit kërkuan informacion mbi procedurën dhe kushtet për lirim të parakohshëm përmes lirit me kusht dhe me vendim të drejtorit të institucionit. Ata deklaruan se kanë pritur muaj me radhë për një përgjigje ndaj kërkesave të parashtruara për falje dhe lirim me kusht.

Për më tepër, disa nga të dënuarit që kishin nevojë për ndërhyrje mjekësore kërkuan informacion mbi kushtet për përdorimin e ndërprerjes së dënimit.

Njëri prej të dënuarve deklaroi se ai duhet të paraqitet në gjykatë në një datë të caktuar, por nuk i ka arritur ftesa, e as informacioni se për se duhet të paraqitet në gjykatë: në cilësinë e të pandehurit, dëshmitarit apo diçka tjetër. Institucioni na njoftoi se ky është një lëshim i gjykatës, që letrat ia adreson vetëm institucionit i cili gjithsesi e çon të dënuarin në seancë, por për shkak se letrat nuk i adresohen personit të dënuar, ato nuk iu dorëzohen atyre. Me këtë praktikë shkelet e drejta e të dënuarve për pranimin e paketave, letrave dhe korrespondencave me institucionet.

Më 24 shtator, 2020, nëntë të dënuarve iu ofrua ndihma e drejtpërdrejtë juridike nga një avokat në kuadër të projektit. Të njëjtit u njoftuan me mekanizmat për mbrojtje nga tortura.

Shtatë nga të dënuarit kërkuan informacion mbi lirimin e parakohshëm me një vendim për lirim me kusht. Një person i dënuar kërkoi transferim në ShNK Idrizovë.

### **Rekomandime:**

- Të pajiset shëtitoret e burgut me rekuizite që do t'u shërbejnë personave të dënuar që ta kalojnë kohën e tyre të lirë në mënyrë më produktive.

- Nga ana e burgut, rregullisht dhe me kohë të lajmërohen të gjithë personat në Fondin për Sigurim Shëndetësor që ata në mënyrë të pandërprerë ta ushtrojnë të drejtën e tyre për kujdes shëndetësor.

Është vërejtur nivel i ulët i higjienës në një pjesë të madhe të hapësirave të institucionit për shkak të të cilave është e nevojshme të blihen rregullisht pajisje për higjienë për të dënuarit në mënyrë që të mbrohen nga përhapja e virusit KÖVID-19.

## REKOMANDIME TË PËRGGJITHSHME:

- Të merren menjëherë dhe urgjentisht masa nga Ministria e Shëndetësisë për sigurimin e qasjes së papenguar në kujdesin shëndetësor për të gjithë të dënuarit.
- Të sigurohen paketa higjienike për të gjithë personat e dënuar në të gjithë institucionet dhe të përmirësohet higjiena në Burgun Tetovë, Burgun Manastir dhe Burgun Kumanovë, me qëllim të parandalimit të përhapjes së virusit KOVID-19.
- Në rast të kufizimit të kontaktit fizik të të dënuarve me botën e jashtme, Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve duhet të vazhdojë të gjejë mënyra alternative që personat e dënuar të kenë kontakte me të afërmit e tyre.
- Brenda çdo institucioni ndëshkimor-korrektues dhe edukativ-korrektues të sigurohen hapësira për vetëizolim të personave që do të shfaqin simptoma të KOVID-19. Këto hapësira kërkojnë të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare.
- Të regjistrohen të gjitha denoncimet për torturë, keqtrajtim dhe trajtim çnjerëzor ndaj personave të dënuar, pa dallim nëse kryhen nga personat e punësuar në institucion ose midis personave të dënuar.
- Të informohen personat e dënuar për të drejtat e tyre përmes afisheve, fletushkave, broshurave dhe të ngjashme, të cilat do të vendosen në vende publike në të gjithë institucionet ndëshkimore-korrektuese.

- > Të sigurohen kushte materiale përkatëse nëpër institucionet me qëllim që të mundësohet trajtimi njerëzor i personave të dënuar.
- > Të angazhohet staf adekuat nëpër institucionet sa i përket risocializimit, zhvillimit dhe implementimit të programeve adekuate të risocializimit.
- > Të mundësohet qasje në arsimin, në veçanti për fëmijët e privuar nga liria (këtë vit është zhvilluar mësim vetëm për arsimin fillor në Burgun Ohër dhe ShEK Tetovë e cila funksiononte në kuadër të Burgut Ohër).
- > Të gjendet një zgjidhje afatgjatë e problemit të furnizimit me ujë në Burgun Kumanovë, duke e marrë parasysh faktin se uji është një nga të drejtat themelore të njeriut dhe mungesa e qasjes në ujë, veçanërisht në kushtet e një pandemie, do të thotë ekzistencë në kushte çnjerëzore për të dënuarit.
- > Të bëhen përpjekje për angazhim profesional me punë të të dënuarve dhe zhvillimin e aftësive të punës që do të ishin të dobishme për ta, pas përfundimit të dënimit me burg.
- > Bashkëpunim midis qendrave për punë sociale dhe Agjencisë së Punësimit me qëllim të ndihmës postpenale për personat e dënuar.
- > Të sigurohen kushte adekuate për fëmijët që e vuajnë dënimin me burg në Burgun Ohër, të cilët për momentin janë në kundërshtim me të gjithë standardet ndërkombëtare. Duhet të hapet një objekt krejtësisht i ri ose fëmijët të transferohen në ShEK Vollkovi.

# ANEKS 1 – PASQYRË TABELARE E VIZITAVE MONITORUESE

DATA	INSTITUCIONI NDËSHKIMOR-KORREKTUES OSE INSTITUCIONI EDUKATIVO-KORREKTUES	PERSONA TË PRANISHËM
10.08.	SHNK Idrizovë	Sibel Amet, Arben Gudaçi
21.08. (vizitë shtesë)	SHNK Idrizovë	Arben Gudaçi
18.08.	SHNK Shtip	Arben Gudaçi, Irena Zdravkova
14.09. (vizitë shtesë)	SHNK Shtip	Irena Zdravkova
03.09.	ENK Burgu Prilep	Ina Xhugumanova, Arben Gudaçi, Irena Zdravkova, Sibel Amet
10.09.	ENK Burgu Strugë	Ina Xhugumanova, Arben Gudaçi, Irena Zdravkova, Sibel Amet
04.09.	ENK Burgu Manastir	Ina Xhugumanova, Arben Gudaçi, Irena Zdravkova, Sibel Amet
24.08.	ENK Burgu Gjevgjeli	Sibel Amet, Arben Gudaçi
15.09.	SHNK Kumanovë	Ina Xhugumanova, Irena Zdravkova, Arben Gudaçi, Vildan Dërpljanin



↓ DATA	↓ INSTITUCIONI NDËSHKIMOR-KORREKTUES OSE INSTITUCIONI EDUKATIVO-KORREKTUES	↓ PERSONA TË PRANISHËM
25.09.	Pavijoni i hapur i SHNK Kumanovë – Kriva Pallankë	Ina Xhugumanova, Arben Gudaçi
11.09.	ENK Burgu Ohër dhe Shtëpia edukativo -korrektuese – Tetovë në kuadër të ENK Burgu Ohër	Ina Xhugumanova, Arben Gudaçi, Irena Zdravkova
01.10. (vizitë shtesë)	ENK Burgu Ohër dhe Shtëpia edukativo -korrektuese – Tetovë në kuadër të ENK Burgu Ohër	Ina Xhugumanova, Arben Gudaçi
04.08.	ENK Burgu Shkup	Arben Gudaçi, Sibel Amet
29.09. (vizitë shtesë)	ENK Burgu Shkup	Arben Gudaçi
20.08.	KENK Burgu Strugë	Ina Xhugumanova, Arben Gudaçi, Irena Zdravkova, Sibel Amet
13.08.	ENK Burgu Tetovë	Sibel Amet, Arben Gudaçi

\* Vizitat shtesë kishin për qëllim të ofronin ndihmë juridike për personat e dënuar.

**RAPORTI I PARË PËR GJENDJEN DHE KUSHTET NË INSTITUCIONET  
NDËSHKIMORE-KORREKTUESE DHE EDUKATIVO-KORREKTUESE  
NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT PËR PERIUDHËN  
I GUSHT - I TETOR 2020**